




Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

22/2024

MOS EFIKASITETI I HETIMIT PARLAMENTAR

Mungesë e vullnetit dhe
problemet ligjore



Prishtinë, 2024

Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala dhe Melos Kolshi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT

- 08 1. Përmbledhje ekzekutive
- 12 2. Rëndësia e Hetimit Parlamentar në sistemet demokratike
- 13 3. Parimet kushtetuese dhe modeli i hetimit parlamentar në Kosovë
- 14 4. Komisionet hetimore parlamentare të themeluara sipas legjislativave
- 15 4.1 Legjislativa II (2004-2007, koalicioni qeverisës LDK - AAK)
- 15 4.2 Legjislativa IV-të (2010-2014, koalicioni qeverisës PDK - AKR dhe të tjerët)
- 16 4.3 Legjislativa VI-të (2017-2019, koalicioni qeverisës PDK - AAK - NISMA)
- 18 4.4 Legjislativa VII-të (2019-2021, koalicioni qeverisës LV - LDK dhe LDK-AAK-NISMA)
- 20 4.5 Legjislativa VIII-të (2021-2024, Lëvizja VETËVENDOSJE!)
- 25 5. Refuzimi i shumicës parlamentare për themelimin e katër komisioneve hetimore
- 28 6. Kaosi në komisionin hetimor për rastin e gjenistëve
- 29 7. Qeveria dhe Kuvendi janë vonuar në adresimin e gjetjeve nga hetimi për gjenistët tek Ligji për të Huajt
- 29 8. Ndërhyrja në sistemin e drejtësisë përmes tentativës për themelimin e Komisionit hetimor parlamentar lidhur me mashtrimet me listat e veteranëve të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
- 30 9. Kundërkushtetutshmëria dhe ndërhyrja në sistemin e drejtësisë përmes Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje
- 31 10. Procedimi i kundërligjshëm i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- 33 11. Shumica parlamentare pamundësoi kryerjen e mandatit të Komisionit Hetimor
- 34 12. Abuzimi me të drejtën e shumicës
- 35 13. Mbarëvajtja e mbledhjeve
- 37 14. Refuzimi për të hetuar çështjen e propozuar
- 38 15. Ushtrimi i detyrës përtej përkatësisë partiake
- 39 16. Dështimi i Kuvendit për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore parlamentare
- 39 17. Të metat e Ligjit Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar
- 40 a) Detyrimi për të themeluar KHP-të pa votim formal në seancë plenare kur inicimi bëhet nga 1/3 e deputetëve
- 41 b) Një më shumë për "opozitën"
- 42 c) E drejta e propozuesit për të drejtuar KHP-në
- 43 d) Caktimi i afatit për t'i propozuar anëtarët
- 44 e) Objekti i hetimit nuk mund të jetë çështje kontestimi
- 45 f) Buxheti i Komisionit në Kryesi dhe jo në seancë plenare
- 45 g) Masat/ndëshkimet financiare
- 46 h) Dërgimi i raportit për KHP-të te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe te Prokurori i Shtetit
- 47 i) Konflikti i interesit gjatë ushtrimit të detyrës
- 48 j) Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve
- 48 k) Çështje të tjera teknike dhe administrative

SHKURTESAT

KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
GP LV	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
GP PDK	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
GP LDK	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
GP AAK	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
GP MULTIETNIK	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
RRPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
GJK	Gjykata Kushtetuese

1. Përmbledhje ekzekutive

Shumica parlamentare dhe opozita janë pjesë përbërëse në një demokraci kushtetuese dhe parlamentare dhe pjesë e pandashme e pluralizmit politik. Në një demokraci të mirëfilltë partia në pushtet udhëheq me institucionet publike sipas Kushtetutës dhe ligjit por njëkohësisht mirëkupton dhe ofron hapësirë dhe respekt për rolin e opozitës dhe të pakicës parlamentare, duke siguruar kushtet e nevojshme për funksionimin e tyre.

Promovimi dhe konsolidimi i demokracisë pluraliste është një nga objektivat kryesore të Këshillit të Evropës dhe Asamblesë së tij Parlamentare, duke inkurajuar shtetet anëtare dhe aspiruese të ndërtojnë standarde të përbashkëta për një demokraci parlamentare të lirë. Cilësia demokratike matet nga mjetet në dispozicion të opozitës për të kryer detyrat e tyre, duke mbikëqyrur dhe mbajtur qeverinë përgjegjëse, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe parandalimin e keqpërdorimeve.

Përmirësimi i marrëdhënieve mes shumicës dhe opozitës kërkon respektimin e pluralizmit, bashkëpunimit dhe vendimmarrjes efektive, parime thelbësore për një demokraci parlamentare si Kosova. Megjithatë, gjatë dy dekadave të parlamentarizmit, që nga viti 2001, këto tre parime kryesore kanë dështuar të gjejnë zbatim të pranueshëm për një demokraci parlamentare, ku në disa legjislatura ka gjetur zbatim më pak dhe në disa më shumë, sidomos në rastet e themelimit të komisioneve hetimore.

Sa i përket parimit të pluralizmit, në një shtet demokratik ai duhet të respektohet në nivelin më të lartë, pasi kritika nga opozita nuk duhet të shihet në asnjë rrethanë si element shkatërrues, përkundrazi, zëri i saj duhet të dëgjohet dhe të trajtohet me respekt. Një shtet demokratik nuk mund të funksionojë pa balancimin e pushteteve ndërmjet institucioneve shtetërore. Për më tepër, shumica dhe opozita duhet të ndajnë një përgjegjësi të përbashkët ndaj shoqërisë, duke ndjekur parimin e solidaritetit politik që shkon përtej ndarjeve partiake.

Shumica duhet të ushtrojë pushtetin me vetëpërmbytje dhe respekt ndaj opozitës, duke ndjekur qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente, me vetëdijen se një ditë mund të kalojë në opozitë. Ndërkohë, opozita duhet të respektojë rregullat procedurale dhe të shmangë abuzimin e të drejtave të saj, duke mbajtur një përgjegjësi të përbashkët me shumicën për të përfaqësuar interesat e shoqërisë.

Në 23 vite nga konstituimi i Kuvendit të Kosovës më 2001, janë krijuar gjithsej 15 komisione hetimore parlamentare. Njëri prej tyre u krijua para shpalljes së pavarësisë, ndërsa të tjerët pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Hetim Parlamentar më 2010.

Në Legjislaturën II dhe IV u krijua nga një komision hetimor, ndërsa në Legjislaturën III dhe V nuk pati asnjë. Një rritje e dukshme e aktiviteteve hetimore është vërejtur duke filluar nga Legjislatura VI, e cila themeloi katër komisione.

Kjo prirje vazhdoi me Legjislaturën VII, që themeloi tre komisione, dhe arriti kulmin në Legjislaturën VIII me gjashtë komisione. Të dhënat statistikore tregojnë një prirje drejt intensifikimit të hetimeve parlamentare në vitet e fundit. Nga Legjislatura I deri në Legjislaturën V janë themeluar gjithsej dy komisione, ndërsa në tri legjislaturat e fundit (VI, VII, dhe VIII) janë themeluar 13 komisione, që përbëjnë shumicën dërrmuese të komisioneve hetimore në historinë e Kuvendit të Kosovës.

Megjithatë, shumica e këtyre komisioneve hetimore nuk arritën qëllimin kryesor – zbardhjen e fakteve. Shpeshherë, në komisionet e themeluara, dy palët (shumica parlamentare dhe opozita/pakica), veçanërisht shumica parlamentare mbetën në pozitat përmes së cilave bënë obstrukcione që hetimi parlamentar të mos realizohej. Nga këndvështimi i jashtëm duke parë këtë qasje të pushtetit dhe opozitës, fiton besimin se deputetët që marrin pjesë në këto komisione hetimore nuk udhëhiqen nga parimet e mbrojtjes së interesit publik dhe sqarimit të rrethanave lidhur me çështjen që është subjekt i hetimit, por keqpërdorim i pushtetit dhe fuqisë politike për të penguar zbardhjen e të vërtetës më çdo çmim, duke iu ofruar pandëshkueshmëri zyrtarëve publik kur ka dyshime se janë të përfshirë në keqeverisje apo keqpërdorime të detyrës zyrtare. Kjo në masë të madhe ka qenë e shprehur në Legjislaturën e VIII-të.

Komisionet hetimore në vend se të ndërtojnë kulturë të bashkëpunimit për të zbardhur çështjet që i kanë pasur në punë dhe për të bindur publikur lidhur me mënyrën e qeverisjes nga ministritë apo institucionet kompetente, përkundrazi kanë ndërtuar një kulturë të konfrontimit që është përcjellur me përplasje të vazhdueshme dhe të ashpra ndërmjet deputetëve të partive të ndryshme, të cilat shpesh devijonin nga çështjet kryesore të hetimeve. Gjithashtu, në disa raste shumica parlamentare ka refuzuar formimin e komisioneve të kërkuara nga 1/3 e deputetëve, duke shkelur detyrimet ligjore dhe kushtetuese që kërkojnë ngritjen e tyre pa u varur nga vullneti i grupeve parlamentare. Ky refuzim përbën shkelje të qartë të Ligjit për Hetim Parlamentar dhe një pengesë serioze për funksionimin demokratik të Kuvendit, si dhe promovim i kulturës së pandëshkueshmërisë për personat që potencialisht kanë mundur të jenë të përfshirë në aktivitete që cenojnë vlerat apo parimet e mbrojtura me Kushtetutë dhe ligj.

Në disa raste, në Legjislaturën e VIII-të, shumica parlamentare ka pamundësuar punën e komisioneve përmes bojkotit dhe mungesës së kuoromit, duke vonuar proceset hetimore dhe nxjerrjen e përfundimeve. Këto veprime, të motivuara nga përplasjet politike apo mospajtimet mbi temat e diskutimit, kanë dëmtuar transparencën dhe përgjegjshmërinë. Veprimet e tilla përbëjnë shembull të qartë të mungesës së vullnetit politik për të zbatuar obligimet që lidhen me llogaridhënien dhe transparencën dhe për të ndjekur çështjet që lidhen me dyshimet të caktuara.

Përkundër gjetjeve dhe raportit të miratuar nga Kuvendi për çështjen e gjenitëve, as Qeveria dhe as Kuvendi nuk kanë arritur të adresojnë problemet dhe të miratojnë Ligjin për të Huaj për më shumë se pesë vite. Në raste të tjera, Kuvendi ka ndërhyrë në mënyrë të diskutueshme në sistemin e drejtësisë, si në tentativën për themelimin e komisionit hetimor për mashtrimet me listat e veteranëve të UÇK-së apo në themelimin e një komisioni kundërkushtetues për dhunën seksuale dhe në familje.

Në disa raste, shumica parlamentare abuzoi me të drejtën që i'a jep fuqia politike e dalur nga zgjedhjet. Ligji për Hetim Parlamentar, ka precizuar në mënyrë të qartë dhe të saktë se çfarë çështjesh mund të propozohen për t'u hetuar. Në shumicën e rasteve, çështjet që janë propozuar kanë qenë çështje në pajtim me kërkesat e ligjit për hetim parlamentar. Por, në mënyrë të hapur një dispozitë e tillë është shkelur nga shumica parlamentare në Legjislaturën e VIII-të. Refuzimi për të themeluar komisionin hetimor për energjinë elektrike, për hetimin në lidhje me rezervat shtetërore, për hetimin e kontratave njëburimore, përbën situatë kur shumica parlamentare abuzon me të drejtën e saj dhe refuzimin e saj për të hetuar çështje që mund të shpien në gjetje për ministra prej nga partia politike që janë votuar.

Një pjesë e deputetëve të Kuvendit, nuk e ushtruan detyrën e tyre përtej përkatësisë partiake kur kihet parasysh se kjo është një kërkesë qenësore për ruajtjen e paanshmërisë dhe integritetit të procesit hetimor. Anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar (KHP) duhet të kuptojnë se hetimi i çështjeve të rëndësishme ka pasoja të mëdha për jetën publike dhe duhet të trajtohet me seriozitetin e kërkuar, pa ndikime të jashtme nga partitë politike.

Sigurimi i llogaridhënies, promovimi i besimit publik dhe mbrojtja e vlerave demokratike varen thelbësisht nga transparenca në funksionimin e komiteteve hetimore parlamentare. Fatkeqësisht, pjesa dërrmuese e Komisioneve Hetimore Parlamentare (KHP) të krijuara kanë dështuar në mënyrë të konsiderueshme në mbajtjen e këtyre parimeve. Mungesa e transmetimeve live nga Kuvendi, dështimi për të publikuar dokumente zyrtare dhe mungesa e të dhënave në faqen zyrtare të Kuvendit janë probleme kryesore që kanë ndikuar negativisht në funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare, duke minuar seriozitetin dhe qëllimin e tyre.

Përveç gjetjeve nga analiza e këtyre komisioneve hetimore, IKD ka evidentuar edhe të metat e Ligjit për Hetim Parlamentar, për të cilat Kuvendi duhet që në një afat sa më të shpejtë t'i nisë ndryshimet e nevojshme.

Ndër problemet kryesore janë paqartësitë në përcaktimin e kompetencave të komisioneve, kufizimin që grupit nismëtar të mos i takojë kryesimi, qartësimi i detyrimit për themelimin e KHP-ve nga 1/3 e deputetëve, mungesa e afateve kohore të qarta për hetimet, dhe kufizimet në qasjem e dokumenteve ose dëshmitarëve. Më tutje, çështje që duhet të rregullohet është edhe caktimi i afatit për t'i propozuar anëtarët, buxhetimi i Komisionit në Kryesi dhe jo në seancë plenare, konflikti i interesit gjatë ushtrimit të detyrës, dërgimi formal i raportit për KHP te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe te Prokurori i Shtetit, monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe disa çështje të tjera teknike dhe administrative.

Sipas ligjit, shumica parlamentare ka një anëtar më shumë, çka në praktikë ka rezultuar me mbivotim të opozitës ose me mungesa të qëllimshme që bllokojnë punën e komisionit. Për të adresuar këtë, propozimet sugjerojnë një përfaqësim më të balancuar. Kjo do të ndihmonte në parandalimin e abuzimeve nga shumica dhe garantimin e një procesi hetimor me integritet.

Ligji aktual parashikon që kryesuesi të mos jetë nga grupi iniciator, një dispozitë që perceptohet si kufizuese. Kjo dispozitë të rishikohet për të lejuar që grupi iniciator të propozojë kryesuesin, duke marrë parasysh njohuritë dhe përkushtimin e grupit inicues për çështjen e hetuar.

Një tjetër aspekt problematik është caktimi i afateve për dorëzimin e nominimeve nga grupet parlamentare. Ligji aktual nuk përcakton një afat kohor, gjë që çon në vakum procedural dhe vonesa në formimin e komisioneve. Propozimi për një afat shtatëditor do të siguronte efikasitet dhe disiplinë në proces.

Po ashtu, është e domosdoshme që të vendosen dispozita për adresimin e konflikteve të interesit, duke përfshirë deklarin dhe trajtimin e tyre për të siguruar paanshmëri dhe transparencë.

Sa i përket buxhetimit, procedurat aktuale kërkojnë që miratimi i buxhetit të komisioneve të bëhet në seancë plenare, çka krijon burokraci dhe kufizon autonominë e tyre. Një qasje më e thjeshtuar, ku buxheti miratohet nga Kryesia e Kuvendit, do të eliminonte vonesat dhe do të siguronte funksionalitet më të madh për komisionet.

Ligji për Hetim Parlamentar nuk adreson në mënyrë të qartë situatat ku deputetët bllokojnë qëllimisht punën e komisioneve. Propozimi për masa financiare dhe disiplinore për mungesat e pajustificuara dhe sjelljet obstruksioniste do të ndihmonte në sigurimin e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë.

Dorëzimi formal i raporteve të komisioneve hetimore te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Prokurori i Shtetit është thelbësor për nisjen e hetimeve dhe rritjen e përgjegjësisë institucionale. Kjo praktikë siguron që gjetjet të merren seriozisht dhe të hetohen në mënyrë të pavarur. Po ashtu, një komunikim i tillë zyrtar mund të përdoret si provë në procese ligjore dhe të shërbejë si mekanizëm mbikëqyrjeje.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të komisioneve hetimore është një tjetër sfidë. Mungesa e një mekanizmi efektiv për ndjekjen e tyre ka çuar në injorimin e rekomandimeve, duke zvogëluar ndikimin e hetimeve parlamentare. Një mekanizëm i posaçëm për monitorim, i mbështetur nga një njësi e brendshme e Kuvendit, mund të përmirësojë ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve.

Probleme të tjera teknike dhe administrative përfshijnë mungesën e ambienteve të përshtatshme për mbledhjet e komisioneve dhe çështje etike në sjelljen e deputetëve gjatë hetimeve. Për shembull, gjatë një hetimi të rëndësishëm, ndërveprimet e afërta mes deputetëve dhe personave të hetuar kanë komprometuar integritetin e procesit. Për të adresuar këto, është e nevojshme që Kuvendi të sigurojë salla të përshtatshme dhe të adoptojë protokolle për sjelljen gjatë seancave hetimore.

2. Rëndësia e Hetimit Parlamentar në sistemet demokratike

Në sistemet demokratike parlamentare, komisionet hetimore paraqesin mjete më të avancuara të kontrollit parlamentar në krahasim me instrumentet e tjera, siç janë pyetjet parlamentare, interpelancat, seancat e jashtëzakonshme dhe raportimet periodike në komisione dhe në seanca plenare.

Hetimi parlamentar është një komponent kyç i mbikëqyrjes parlamentare në një sistem demokratik, duke stimuluar transparencën, përgjegjshmërinë, pjesëmarrjen e publikut dhe zhvillimin e politikave. Në këtë kuadër, rezultatet e komisioneve hetimore sigurojnë që autoriteti i qeverisë dhe i ministrive përkatëse të ushtrohet në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të qytetarëve. Në të kundërt, ato ndihmojnë në identifikimin e rasteve të abuzimit me pushtetin. Përmes komisioneve hetimore, deputetët, veçanërisht ata të opozitës, fitojnë një mjet të fuqishëm për të ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e qeverisë.[1]

Hetimi parlamentar, shërben për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies, kontrollin e aktiviteteve të qeverisë për t'u siguruar që ajo ka funksionuar brenda kufijve të ligjit dhe respektimit të parimeve të demokracisë dhe se nuk është abuzuar me pushtetin. Më tutje, hetimi parlamentar presupozon që edhe të parandalojë abuzimet e mundshme të pushtetit ekzekutiv, korrupsionin dhe keqmenaxhimin.

Përveç identifikimit të shkeljeve të mundshme të ligjit ose të procedurave të pasakta të ndjekura nga pushteti ekzekutiv, hetimi parlamentar ka si synim edhe evidentimin e dobësive në politikat dhe procedurat ekzistuese. Ky proces çon në zhvillimin e përmirësimeve dhe reformave, të cilat janë thelbësore për përparimin e administratës publike dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është angazhimi i publikut. Hetimi parlamentar shpesh përfshin dëgjimin e palëve të interesuara, ekspertëve dhe qytetarëve, të cilët mund të kontribuojnë me informacionet e tyre për të mbështetur gjetjet e raportit të Komisioneve Hetimore Parlamentare.

Në disa raste, rezultatet e komisioneve hetimore mund të duken të parëndësishme dhe shpeshherë paraqiten si të tilla. Kjo është shpesh për shkak të mungesës së një udhëheqjeje të fuqishme dhe të principit për llogaridhënie, si dhe për shkak të pamundësisë për të ndjekur pasojat politike ndaj bartësve të pushtetit. Po ashtu, një faktor që ndikon në inkurajimin e mosdënimit është mungesa e pasojave juridike për përgjegjësit e institucioneve që dalin në përfundimet e Komisioneve Hetimore Parlamentare.

[1] *Udhëzime procedurale mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e opozitës në një parlament demokratik Rezoluta 1601 (2008); Asambleja Parlamentare; Debati në Asamblenë Parlamentare më 23 janar 2008 (Seanca e 6-të); (shih Dokumentin 11465; Raporti i Komitetit për Rregullat e Procedurës, Imunitetet dhe Çështjet Institucionale, raportues: Z. Van Overmeire); Teksti u miratua nga Asambleja më 23 janar 2008 (Seanca e 6-të); (Shih linkun: <https://pace.coe.int/en/files/17626/html>), (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).*

Për këto arsye, dhe veçanërisht për mungesën e pasojave juridike, ky punim do të ofrojë propozime për krijimin e mekanizmave që sigurojnë pasoja ligjore për ata që ushtrojnë pushtetin ekzekutiv.

3. Parimet kushtetuese dhe modeli i hetimit parlamentar në Kosovë

Në modelin kushtetues parlamentar, qeveritë janë politikisht përgjegjëse para parlamentit. Ato i nënshtrohen mbikëqyrjes parlamentare, që përbën një nga funksionet themelore demokratike të Kuvendit në raport me organin ekzekutiv. Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita të përgjithshme mbi këtë çështje, ndërsa detajet për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e kësaj mbikëqyrjeje i janë lënë Rregullores së Punës së Kuvendit. Kjo rregullore ka paraparë një sërë instrumentesh për realizimin e këtij funksioni, duke përfshirë: pyetjet parlamentare, interpelancat, kërkesat për seanca të jashtëzakonshme, raportimet pranë komisioneve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe seancat dëgjimore në komisione parlamentare.

Kontrolli parlamentar shtrihet dhe më tej përmes mundësisë ligjore për ngritjen e komisioneve hetimore, të cilat rregullohen nga Kushtetuta[2] dhe nga një ligj të veçantë. Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar[3], i miratuar në korrik të vitit 2010 nga Kuvendi i Kosovës, ofron bazën ligjore për themelimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të këtij ligji, janë identifikuar probleme procedurale dhe përmbajtësore, të cilat ende nuk janë adresuar në mënyrë të plotë nga legjislativi.

E drejta për hetim parlamentar është një instrument i rëndësishëm që i vihet në dispozicion fillimisht pakicës parlamentare (*së paku 5% e deputetëve duke propozuar dhe nga 1/3 e deputetëve duke themeluar detyrimisht KHP*) për të ushtruar kontroll mbi ekzekutivin dhe për të kërkuar përgjegjësi nga mbajtësit e pushtetit. Në sistemet parlamentare, ku qeveria formohet nga shumica parlamentare dhe ku kjo shumicë ka mjete të fuqishme ligjore për të mbrojtur ekzekutivin, kontrolli hetimor është njohur si një e drejtë e pakicës parlamentare. Nëse ky mjet përdoret me profesionalizëm dhe në përputhje me normat ligjore, komisionet hetimore parlamentare mund të shndërrohen në një mekanizëm të fuqishëm kushtetues dhe ligjor për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Përkundër rëndësisë së instrumenteve të mbikëqyrjes parlamentare, praktika ka treguar se zbatimi i tyre në Kosovë ka qenë e ndërlikuar dhe cenuar nga mungesa e vullnetit politik, nga ndërhyrjet politike, nga baza e dobët ligjore dhe nga mungesa e kapaciteteve profesionale. Shpeshherë, interpelancat dhe pyetjet parlamentare përdoren më shumë si mjete politike për të krijuar presion publik sesa si mekanizma të mirëfilltë për llogaridhënie. Në anën tjetër, një problem mjaft i madh mbetet edhe qasja e kufizuar dhe arroganca e qeverisë që të përgjigjen dhe të jenë llogaridhënese përballë përfaqësuesve të qytetarëve.

Një tjetër aspekt kritik është roli i komisioneve parlamentare në mbikëqyrjen e qeverisë. Në teori, këto komisione ofrojnë një hapësirë për analiza më të thelluara dhe për trajtim më të specializuar të çështjeve specifike, siç janë politikat ekonomike, drejtësia apo siguria kombëtare.

[2] Neni 77, par. 2; Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 20 korrik 2010.

[3] Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 20 korrik 2010.

Megjithatë, sfidat e menaxhimit, mungesa e ekspertizës së duhur dhe polarizimi politik brenda komisioneve shpeshherë dëmtojnë efektivitetin e tyre. Për të rritur ndikimin e tyre, është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të investojë në fuqizimin e këtyre komisioneve përmes trajnimeve profesionale dhe përfshirjes së ekspertëve të pavarur.

Pavarësia dhe integriteti i komisioneve hetimore janë vendimtare për sigurimin e një kontrolli të balancuar dhe objektiv mbi ekzekutivin. Fatkeqësisht, ka pasur raste kur këto komisione janë përdorur për qëllime të ngushta partiake, duke minuar besimin e publikut në këtë instrument demokratik. Për të shmangur një situatë të tillë, është thelbësore që procesi i formimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore të bëhet në mënyrë transparente dhe duke respektuar parimin e barazisë ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare dhe të së paku një të tresës së deputetëve të Kuvendit. Në këtë mënyrë, komisionet hetimore mund të shërbejnë si garantues të drejtësisë dhe si një mjet për rritjen e përgjegjshmërisë publike.

4. Komisionet hetimore parlamentare të themeluara sipas legjislatrave

Për 23 vite prej që është konstituar për herë të parë Kuvendi i Kosovës me 10 dhjetor 2001, janë themeluar 15 komisione hetimore parlamentare. Një komision është themeluar para shpalljes së pavarësisë së Kosovës në bazë të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Të gjitha komisionet e tjera janë themeluar pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe pas miratimit të Ligjit për Hetim Parlamentar me 4 qershor 2010.[4]

Në Legjislaturën II dhe IV u themelua nga një komision hetimor, ndërsa në Legjislaturën III dhe V nuk pati asnjë. Rritja e aktiviteteve hetimore është vërejtur nga Legjislatura VI e tutje, ku kjo legjislaturë themeloi katër komisione. Ndërkohë, Legjislatura VII kishte tre komisione, ndërsa Legjislatura VIII shënoi numrin më të lartë me gjashtë komisione të themeluara.

Legjislatura	Komisione të themeluara
I	0
II	1
III	0
IV	1
V	0
VI	4
VII	3
VIII	6

Tabela nr. 1 - Numri i komisioneve hetimore të themeluara sipas legjislatrave

[4] Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 20 korrik 2010.

4.1 Legjislatura II (2004-2007, koalicioni qeverisës LDK - AAK)

Komisioni Parlamentar Hetimor lidhur me Raportin e zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për gjetjet faktike në Kuvendin e Kosovës

Ky komision hetimor parlamentar u themelua në bazë të propozimit të deputetit të grupit parlamentar ORA, Gazmend Muhaxhiri.[5] Sipas tij, çështja që duhet të hetohej kishte të bënte me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm mbi gjetjet faktike në Kuvendin e Kosovës, respektivisht ndërtimin e qendrës protokollare administrative Gërmia. Këto gjetje përfshinin shkelje dhe mungesë e transparencës në menaxhimin e buxhetit, transfer i parave pa u kryer punët dhe për blerjen e një veture. Në seancën e dt. 3 nëntor 2006, Kuvendi formoi KHP, autorizimet e së cilit shtriheshin për të bërë hetime lidhur me Raportin për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës dhe që ta ftojë secilin zyrtar të Kosovës për të dëshmuar para komisionit lidhur me çështjen nën hetime.

KHP, në raportin përfundimtar konstatoi dështim në mbikëqyrje gjatë shpenzimit të buxhetit të Kuvendit nga ana e Kryesisë dhe ish-kryetarit të Kuvendit, në kuvend ishte krijuar mjedis organizativ me mungesë të transparencës, tendencë për keqpërdorim të fondeve publike, instalim të praktikave joligjore në procesin e prokurimit, keqpërdorim të hierarkisë zyrtare si dhe në disa raste manipulime fshehje të dokumentacionit zyrtar.[6]

KHP, konstatoi se për gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm, ka ekzistuar përgjegjësia politike e ish-kryetarit të Kuvendit, e Kryesisë së Kuvendit në mandatin e parë dhe e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, si dhe përgjegjësia administrative e ish-sekretarit të Kuvendit dhe e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

4.2 Legjislatura IV-të (2010-2014, koalicioni qeverisës PDK - AKR dhe të tjerët)

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me: faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët digjital dhe masat e ndërmarra me lidhje me këtë rast

Ky komision u themelua me 28 mars 2013, në legjislaturën e IV-të-të e cila zgjati më shumë se tre vite (2010-2014, koalicioni qeverisës PDK - AKR dhe komunitetet e tjera). Komisioni u propozua nga GP i LDK-së[7], i cili për qëllim kishte që të hetonte faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët digjitalë dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast.

[5] *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 3 nëntor 2006; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2006_11_03%20Transkript%20i%20seanc%C3%ABs%20plenare_compressed.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 nëntor 2024).

[6] *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 22 shkurt 2007; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2007_02_22%20Transkript%20i%20seanc%C3%ABs%20plenare.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 nëntor 2024).

[7] *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 28 mars 2013; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2013_03_28_10_4836_al.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 nëntor 2024).

Fillimisht, propozuesi kishte propozuar që puna e KHP-së të përfundonte brenda dy muajve, por një afat i tillë kishte qenë i pamjaftueshëm që të realizohej qëllimi i këtij komisioni. Mbi këtë arsye, Kryetari i KHP-së, deputeti Muhamet Mustafa i kërkoi kuvendit që edhe për një muaj tjetër të zgjasë mandatin të cilin Kuvendi e votoi me 23 maj 2013.

Komisioni mbajti gjithsejt dymbëdhjetë (12) mbledhje dhe ky komision manifestoi gatishmëri për punë konstruktive dhe konsensuale. Të gjitha vendimet në Komision, u morën me konsensus. Komisioni Hetimor Parlamentar në fund nxorri edhe raportin me rekomandime.

4.3 Legjislatura VI-të (2017-2019, koalicioni qeverisës PDK - AAK - NISMA)

Komisioni Hetimor parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Kosovës

Komisioni Hetimor Parlamentar, i themeluar më 1 qershor 2018, hetoi shpenzimet për lobim të Presidencës dhe Qeverisë së Kosovës.[8] Gjatë hetimeve, komisioni identifikoi disa parregullsi dhe mungesë të transparencës në lidhje me kontratat e lobimit. Për shembull, Zyra e Presidentit kishte lidhur një kontratë me kompaninë amerikane "Ballard Partners Inc." për shërbime konsulence strategjike dhe avokimi, me vlerë prej 52,000 dollarësh në muaj, që në total arrinte në 1,248,000 dollarë për dy vjet. Megjithatë, raportet e punës nga kjo kompani nuk u dorëzuan komisionit, duke ngritur dyshime për fshehje të qëllimshme ose mungesë të këtyre raporteve.

Po ashtu, Ministria e Punëve të Jashtme kishte lidhur kontrata me kompani të tjera lobimi, si "Alston & Bird LLP" dhe "Squire Patton Boggs", me vlera prej qindra mijëra dollarësh. Edhe në këto raste, raportet e punës ishin të paplota ose mungonin, duke penguar punën e komisionit. Për shembull, nga 34 muaj të kontratës me "Squire Patton Boggs", komisioni kishte pranuar raporte vetëm për 7 muaj. Për shkak të këtyre obstrukcioneve dhe mungesës së transparencës, komisioni rekomandoi që organet kompetente shtetërore të nisin hetime për obstrukcion të punës së komisionit dhe për sigurimin e dokumentacionit të plotë lidhur me kontratat e lobimit.

Megjithatë, raporti përfundimtar i komisionit, i shqyrtuar më 12 prill 2019, nuk arriti të miratohet përfundimisht për shkak të shpërndarjes së Kuvendit më 22 gusht 2019.[9]

[8] *Procesverbal i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 1 qershor 2018; (Shih linkun: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2018_05_03_10_7389_al.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 nëntor 2024).

[9] *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 22 gusht 2019; (Shih linkun: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2019_08_22_10_8169_al.pdf), (Qasur për herë të fundit me 7 nëntor 2024).

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyesve të lartë civil në Administratën Shtetërore

Komisioni Hetimor Parlamentar për emërimet e shërbyesve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Kosovës u themelua më 28 qershor 2018, me qëllim hetimin e procedurave dhe praktikave të ndjekura gjatë këtyre emërimeve.[10] Megjithatë, ky komision nuk arriti të përgatisë një raport përfundimtar brenda mandatit të tij. Ky komision u propozua nga Partia Socialdemokrate, ata mblodhën nënshkrimet e nevojshme për themelimin e këtij komisioni, me qëllim hetimin e procedurave të emërimit dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale në institucionet publike.

Sipas të dhënave nga Kuvendi i Kosovës, komisionit i kaloi mandati pa përgatitur raportin përfundimtar, duke lënë kështu pa adresuar çështjet për të cilat ishte themeluar. Komisioni Hetimor nuk e dorëzoi Raportin Përfundimtar.[11]

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 shtetasve turq më 29 mars 2018

Më 29 mars 2018, gjashtë shtetas turq u arrestuan dhe u dëbuan nga Kosova drejt Turqisë, një veprim që shkaktoi reagime të ashpra brenda dhe jashtë vendit. Për të hetuar rrethanat e këtij rasti, më 28 qershor 2018, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për ndriçimin e procedurave që çuan në këtë dëbim.[12] Ky komision u propozua nga deputetët Driton Selmanaj dhe Xhelal Sveçla, me qëllim të zbardhjes së shkeljeve të mundshme ligjore dhe kushtetuese gjatë procesit.

Pas hetimeve të gjera, komisioni identifikoi 31 shkelje ligjore dhe kushtetuese në lidhje me arrestimin dhe dëbimin e shtetasve turq. Kryetari i komisionit, Xhelal Sveçla, deklaroi se shkeljet kryesore u kryen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Policia e Kosovës, të cilat, sipas tij, vepruan në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, si dhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Raporti i komisionit theksoi se vendimet për revokimin e lejeve të qëndrimit dhe urdhrat për largim me forcë u nxorën në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, u evidentua se arrestimi dhe dëbimi i shtetasve turq u realizua pa respektuar procedurat e duhura ligjore, duke shkelur të drejtat e tyre themelore.

Më 24 qershor 2019, Kuvendi i Kosovës miratoi raportin e komisionit me 59 vota pro, 2 kundër dhe 4 abstenime. Miratimi i këtij raporti nënkuptonte pranimin e gjetjeve të komisionit dhe kërkonte nga institucionet përkatëse të ndërmarrin veprime të mëtejshme për adresimin e shkeljeve të identifikuara.[13]

[12] *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 18 qershor 2018; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2018_06_14_10_7483_al.pdf), (Qasur për herë të fundit me 7 nëntor 2024).

[13] *Raport i komisionit hetimor parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq me datë 29 mars 2018*; Kuvendi i Kosovës; 24 qershor 2019; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2019_07_22_Raport%20i%20Komisionit%20hetimor%20parlamentar%20n%20C3%AB%20lidhje%20me%20ndri%20C3%A7imin%20e%20rastit%20t%C3%AB%20d%C3%ABbimit%20t%C3%AB%20gjasht%C3%AB%20shtetas%20ve%20turq%20me%2029%20mars%202018.pdf), (Qasur për herë të fundit me 7 nëntor 2024).

Ky rast nxori në pah nevojën për forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies brenda institucioneve të sigurisë në Kosovë, si dhe rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe procedurave ligjore në çdo veprim të autoriteteve shtetërore. Gjithashtu, rasti theksoi domosdoshmërinë e mbikëqyrjes efektive parlamentare për të parandaluar abuzimet me pushtetin dhe për të siguruar funksionimin demokratik të institucioneve.

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Më 7 mars 2019, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për të hetuar gjendjen në Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK) dhe njësinë e saj Vala. Ky komision u propozua nga deputetët e opozitës, të cilët shprehën shqetësime për keqmenaxhimin dhe problemet financiare në këto ndërmarrje publike. Qëllimi kryesor ishte shqyrtimi i kontratave, vendimeve menaxheriale dhe praktikave të punësimit që mund të kishin ndikuar negativisht në performancën e PTK-së dhe Valës.

Gjatë hetimeve, komisioni shqyrtoi dokumentacionin e pranuar nga Posta e Kosovës dhe Telekom i Kosovës, duke përfshirë kontratat dhe marrëveshjet kryesore. Në disa raste, mbledhjet e komisionit u zhvilluan pa praninë e mediave, me kërkesë të dëshmitarëve, për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të diskutuar.

Pavarësisht përpjekjeve, komisioni hasi në vështirësi në përfundimin e hetimeve brenda afatit të caktuar. Më 11 prill 2019, Kuvendi miratoi zgjatjen e mandatit të komisionit, për të mundësuar përfundimin e hetimeve dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.

Megjithatë, për shkak të shpërbërjes së Kuvendit më 22 gusht 2019, komisioni nuk arriti të përgatisë dhe të paraqesë një raport përfundimtar. Si rezultat, gjetjet dhe rekomandimet e pritshme nga ky komision mbetën të papërfunduara, duke lënë pa adresuar çështjet e ngritura lidhur me menaxhimin dhe performancën e PTK-së dhe Valës.

Ky rast nxori në pah sfidat me të cilat përballen komisionet hetimore parlamentare në Kosovë, veçanërisht kur proceset hetimore ndërpriten nga zhvillimet politike si shpërbërja e Kuvendit. Mungesa e një raporti përfundimtar nga ky komision theksoi nevojën për reforma në funksionimin e komisioneve hetimore, për të siguruar që hetimet e nisura të përfundojnë me sukses dhe të kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike.

4.4 Legjislatura VII-të (2019-2021, koalicioni qeverisës LV - LDK dhe LDK-AAK-NISMA)

Komisioni hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e pandemisë së virusit "COVID-19" nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2020, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për të shqyrtuar menaxhimin e pandemisë COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky komision, u propozua nga grupi parlamentar i PDK-së dhe u kryesua nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, kishte për qëllim vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet shtetërore gjatë krizës shëndetësore, duke përfshirë efikasitetin e politikave të zbatuara dhe përdorimin e fondeve publike.

Qëllimi i hetimit përfshinte menaxhimin e pandemisë COVID-19 nga ana e qeverisë, përfshirë këtu menaxhimin e pandemisë në aspektin legjislativ, pra bazën ligjore për marrjen e vendimeve nga ana e Qeverisë së Kosovës, bazën e menaxhimit të procedurave në karantinë, si dhe menaxhimin e procesit nga të gjitha agjencionet kërkuese, si QKUK dhe komunat, për furnizimin e tyre me pajisjet e nevojshme medicinale.

Gjatë hetimeve, komisioni zhvilloi takime me zyrtarë të lartë qeveritarë, përfaqësues të institucioneve shëndetësore dhe ekspertë të fushës, për të mbledhur informacione të detajuara mbi përgjigjen institucionale ndaj pandemisë. Një nga këto takime përfshinte edhe Presidenten e Këshillit Kombëtar Zviceran, Isabelle Moret, duke reflektuar përpjekjet për të mësuar nga praktikat ndërkombëtare në menaxhimin e krizës.

Komisioni analizoi gjithashtu dokumente zyrtare, raporte dhe të dhëna statistikore për të vlerësuar ndikimin e masave të marra në shëndetin publik dhe ekonominë e vendit. Përmes këtyre analizave, synohej identifikimi i sfidave dhe mangësive në menaxhimin e pandemisë, me qëllim ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e politikave të ardhshme shëndetësore dhe emergjente.

Komisioni Hetimor nuk arriti ta përgatisë Raportin Përfundimtar, pasi Kuvendi u shpërnda para përfundimit të mandatit të rregullt.

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë u themelua më 10 korrik 2020, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Ky komision u kryesua nga deputeti Hajrulla Çeku i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Në arsyetimin e propozimit të deputetit Bedri Hamza, i mbështetur edhe nga 21 (njëzet e një) deputetë tjerë, për formimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar, theksohet se: "Për hetimin e përgjithshëm të procesit të privatizimit në Kosovë, nga fillimi i tij, e deri në ditët e sotme, përkatësisht hetimin e të gjithë procesit të privatizimit të menaxhuar dhe administruar fillimisht nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), pastaj Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), procesi i cili ka të bëjë me të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni, për sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, ndërmarrjeve publike, duke përfshirë edhe metodat dhe procedurat e realizuara për qëllime të privatizimit".

Pra, është kërkuar një hetim se kush përfitoi nga privatizimet në Kosovë, me emër dhe mbiemër, të bëhen publike, por edhe shumë pyetje të tjera, që e kanë shoqëruar privatizimin në Kosovë. Komisioni Hetimor nuk arriti ta përgatisë Raportin Përfundimtar, pasi Kuvendi u shpërnda para përfundimit të mandatit të rregullt.

Komisioni Hetimor Parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës

Në vitin 2020, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për të shqyrtuar proceset e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës.

Kjo nismë u iniciua nga deputeti Haxhi Avdyli, i cili shprehu shqetësime lidhur me keqpërdorimet e mundshme në dhënien e lejeve për hidrocentrale. Komisioni u konstituua më 3 gusht 2020, me Eliza Hoxhën si kryetare dhe Haxhi Avdylin si nënkryetar.

Gjatë punës së tij, komisioni intervistoi zyrtarë të lartë, përfshirë Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, dhe përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE). Diskutimet u fokusuan në procedurat e ndjekura për lëshimin e lejeve dhe licencave për hidrocentralet, me theks të veçantë në rastet e kompanive si "Kelkos Energy".

Ende pa u miratuar plani i veprimit, deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje kërkuan që Komisioni Hetimor të marrë vendim për pezullimin e lëshimit të lejeve për hidrocentrale gjatë mandatit të tij. Kjo kërkesë u përcoll me diskutime të gjera në komision, ku u theksua se një vendim i tillë do të ishte joligjor dhe do të përbënte ndërhyrje direkte në punën e ekzekutivit.

Pavarësisht kundërshtimeve, insistimi për pezullimin e lejeve vazhdoi, si brenda komisionit, ashtu edhe përmes presionit të jashtëm. Për të tejkaluar këtë situatë, kërkesa fillimisht u shndërrua nga vendim në rekomandim. Megjithatë, disa anëtarë të komisionit argumentuan se rekomandimet e tilla mund të bëhen vetëm pas përfundimit të hetimeve dhe hartimit të raportit përfundimtar.

Interpretimi ligjor i dhënë më pas nga Zyra Ligjore e Kuvendit të Kosovës, konfirmoi se kërkesa për pezullimin e lejeve, qoftë si vendim apo rekomandim, ishte jashtë kompetencave të komisionit hetimor. Ligji përcakton qartë se një komision hetimor ka për qëllim shqyrtimin e çështjeve dhe nxjerrjen e rekomandimeve vetëm pas përfundimit të mandatit të tij.

Kjo situatë theksoi rëndësinë e respektimit të mandatit dhe kompetencave të përcaktuara për komisionet hetimore, duke shmangur ndërhyrjet në proceset ekzekutive gjatë hetimeve. Kërkesat e tilla u konsideruan si të pabaza dhe të pavlefshme nga këndvështrimi ligjor.

Komisioni Hetimor nuk arriti ta përgatisë Raportin Përfundimtar, pasi Kuvendi është shpërndarë para përfundimit të mandatit të rregullt.

4.5 Legjislatura VIII-të (2021-2024, Lëvizja VETËVENDOSJE!)

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Më 22 shkurt 2022, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) paraqiti kërkesën për themelimin e një Komisioni Hetimor Parlamentar për të hetuar menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo iniciativë synonte të shqyrtonte vendimet, veprimet dhe mosveprimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera në lidhje me sektorin e energjisë, me fokus të veçantë në periudhën e krizës energjetike.

Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e këtij komisioni më 5 maj 2022, me 93 vota pro. Komisioni u konstituua më 16 maj 2022, me deputetin Driton Selmanaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) si kryesues. Mandati i komisionit ishte gjashtë muaj, gjatë të cilëve synohej hetimi i keqpërdorimeve të mundshme në menaxhimin e krizës energjetike.

Gjatë hetimit, komisioni shqyrtoi masat e marra gjatë periudhës së shpalljes së gjendjes emergjente për energjinë, vendimet e qeverisë, si dhe veprimet e institucioneve si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT). Komisioni intervistoi zyrtarë të lartë, përfshirë ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, dhe ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, lidhur me raportimet për përfshirje në skandale financiare.

Në shkurt 2023, komisioni paraqiti raportin përfundimtar në Kuvend, duke identifikuar mangësi në menaxhimin e krizës energjetike dhe duke rekomanduar masa për përmirësimin e situatës. Megjithatë, gjatë seancës plenare të mbajtur më 23 shkurt 2023, raporti nuk u miratua. Nga 77 deputetë të pranishëm, 16 votuan pro, ndërsa 61 abstenuan, kryesisht nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).[14]

Pas dështimit të miratimit të raportit, PDK njoftoi se do të ngrejë kallëzim penal në Prokurorinë Speciale, duke argumentuar se disa veprime gjatë menaxhimit të krizës energjetike përbëjnë vepra penale.

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike

Më 17 maj 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të shqyrtuar procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë gjatë periudhës 2006-2022, duke përfshirë nivelet legjislative, ekzekutive, rregullatore dhe ndërmarrjet publike. Kjo iniciativë u propozua nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, me qëllim hetimin e vendimeve dhe veprimeve në sektorin energjetik gjatë kësaj periudhe.

Komisioni u konstituua më 1 qershor 2022, me deputetin Hajdar Beqa nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) si kryesues. Anëtarët përfshinin deputetë nga Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Lista Serbe dhe grupi multietnik.

Gjatë hetimit, komisioni shqyrtoi dokumente dhe kontrata nga institucionet relevante si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT), Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO). U intervistuan ish-zyrtarë të lartë, përfshirë menaxhmentin e KEK-it dhe KOSTT-it për periudhën 2006-2008, si dhe tre ish-ministra të energjisë.

[14] *Procesverbal i Seancës Plenare*; Kuvendi i Kosovës; 23 shkurt 2023; (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/Proc_nr_99_dt_23_02_2023_SP_gCEUq4fB2B.pdf), (Qasur për herë të fundit me 7 nëtor 2024).

Komisioni identifikoi disa çështje kyçe, si:

- Keqmenaxhimi i aseteve publike: U evidentuan parregullsi në menaxhimin e pronave të KEK-ut, përfshirë shitjen e banesave në pronësi të ndërmarrjes.
- Parregullsi në prokurim: U zbuluan shkelje në procedurat e prokurimit për importin e energjisë elektrike, duke rezultuar në kosto të larta për buxhetin e shtetit.
- Mungesa e transparencës: U vërejtën mangësi në transparencën e vendimmarrjes nga institucionet rregullatore dhe ndërmarrjet publike në sektorin e energjisë.

Më 22 mars 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi raportin përfundimtar të komisionit me 69 vota pro nga 72 deputetë të pranishëm.

Raporti përmbante rekomandime për përmirësimin e menaxhimit dhe transparencës në sektorin e energjisë, si dhe kërkesa për hetime të mëtejshme nga organet kompetente për rastet e dyshuara të keqpërdorimeve.

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës

Më 7 qershor 2023, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për të shqyrtuar trajtimin institucional të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Ky komision u iniciua nga 42 deputetë të Kuvendit, nga GP i LV-së, të cilët nënshkruan kërkesën për themelimin e tij, duke reflektuar shqetësimin e tyre për rritjen e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Komisioni u konstituua më 9 tetor 2023, me deputetin Alban Bajrami nga Lëvizja Vetëvendosje si kryesues. Qëllimi kryesor i komisionit ishte hetimi i rasteve të gjykuara dhe atyre në proces gjyqësor që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe vlerësimi i efikasitetit të institucioneve përgjegjëse në trajtimin e këtyre rasteve.

Gjatë hetimit, komisioni shqyrtoi procedurat e ndjekura nga institucionet si Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale. U analizuan gjithashtu politikat ekzistuese, korniza ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë. Komisioni mbajti takime me përfaqësues të institucioneve relevante, përfshirë ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, për të diskutuar masat e marra dhe sfidat në parandalimin dhe trajtimin e këtyre rasteve.

Komisioni nuk ka arritur të përgatitë raport përfundimtar për shkak të përplasjeve dhe moszëvendësimit të anëtarëve në seancën plenare të datës 15 dhjetor 2023.

Komisioni Hetimor Parlamentar, në lidhje me çështjen: Hetim parlamentar lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore, dhe Hetim parlamentar lidhur me keqpërdorimet dhe abuzimet e mundshme me rezervat shtetërore, nëpërmjet kualifikimit të procedurës, si sekret shtetëror për furnizime të tilla

Më 21 shtator 2023, Kuvendi i Kosovës, bazuar në kërkesën e 41 deputetëve, miratoi themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të hetuar procedurat e furnizimit dhe menaxhimit të rezervave

shtetërore, si dhe dyshimet për keqpërdorime të mundshme përmes kualifikimit të procedurave si sekret shtetëror.

Iniciativa për këtë komision u propozua nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me qëllim hetimin e dyshimeve për abuzime në procesin e furnizimit të rezervave shtetërore, veçanërisht nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e drejtuar nga ministria Rozeta Hajdari.

Pas disa tentativave të pasuksesshme për konstituim, më 30 nëntor 2023, komisioni u konstituua me deputetin Rashit Qalaj nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) si kryesues.

Gjatë hetimit, komisioni shqyrtoi procedurat e furnizimit dhe menaxhimit të rezervave shtetërore, duke u fokusuar në kualifikimin e procedurave si sekret shtetëror. U analizuan dokumente dhe kontrata nga institucionet përkatëse dhe u intervistuan zyrtarë të lartë për të vlerësuar transparencën dhe ligjshmërinë e veprimeve të tyre.

Një nga çështjet kryesore të identifikuara ishte mungesa e transparencës në proceset e prokurimit, veçanërisht në rastet kur procedurat ishin kualifikuar si sekret shtetëror. Kjo praktikë ngjalli shqetësime për mundësinë e keqpërdorimeve dhe abuzimeve me fondet publike.

Komisioni gjithashtu vuri në dukje nevojën për rishikimin e politikave dhe procedurave ekzistuese për menaxhimin e rezervave shtetërore, duke rekomanduar masa për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në këto procese.

Komisioni përfundoi mandatin e tij pa arritur të ndërtojë një plan të mirëfilltë pune dhe pa filluar hetimet, krejt kjo për shkak të vullnetit të shumicës parlamentare për mos ta hetuar çështjen e rezervave shtetërore.

Në përfundim, Komisioni Hetimor Parlamentar për rezervat shtetërore u themelua dhe konstituua pas disa përpjekjeve, por përfundoi mandatin e tij pa arritur rezultate konkrete në hetimet e planifikuara.

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Më 7 mars 2024, Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të hetuar menaxhimin e marrëdhënies së punës së anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Kjo iniciativë u propozua nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), e mbështetur nga tetë deputetë të tjerë të këtij subjekti politik.

Komisioni u konstituua më 27 mars 2024, me deputeten Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) si kryesuese. Në përbërje të tij ishin deputetë nga shumica parlamentare dhe opozita, duke përfshirë përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lista Serbe.

Gjatë hetimit, komisioni shqyrtoi procedurat e rekrutimit, emërimit dhe menaxhimit të stafit në Shërbimin e Jashtëm të Kosovës. U analizuan dokumente zyrtare, u mbajtën seanca dëgjimore me zyrtarë aktualë dhe ish-zyrtarë të MPJD-së, për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve me legjislacionin në fuqi.

Një nga çështjet kryesore të identifikuara ishte mungesa e transparencës në proceset e rekrutimit dhe emërimit në Shërbimin e Jashtëm. U evidentuan raste të emërimeve pa respektuar kriteret ligjore dhe procedurat e konkurrimit, duke ngritur shqetësime për favorizime politike dhe nepotizëm.

Komisioni gjithashtu vuri në dukje mungesën e trajnimeve adekuate për diplomatët e emëruar, gjë që ndikonte në cilësinë e përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Po ashtu, u identifikuan mangësi në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e performancës së stafit diplomatik.

Më 15 nëntor 2024, anëtarët e komisionit dorëzuan dosjen me gjetjet në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, për hetime të mëtejshme lidhur me shkeljet e identifikuara.

Komisioni Hetimor Parlamentar për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të Arsimit fillor dhe Arsimit të Mesëm të Ulët për vitin shkollor 2023/2024

Më 4 prill 2024, Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të hetuar procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët për vitin shkollor 2023/2024. Kjo iniciativë u propozua nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pas akuzave për keqpërdorime dhe manipulime gjatë procesit të subvencionimit.

Gjatë debatit parlamentar, deputetët e opozitës akuzuan ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, për "krim të organizuar" në procesin e subvencionimit të teksteve shkollore, duke pretenduar favorizim të një shtëpie botuese specifike. Në përgjigje, ministrja Nagavci mirëpriti themelimin e komisionit, duke theksuar nevojën për hetimin e keqpërdorimeve të mundshme që kanë ndodhur ndër vite në Ministrinë e Arsimit.

Komisioni u konstituua më 17 maj 2024, duke filluar hetimet mbi procedurat e subvencionimit. Gjatë hetimeve, komisioni shqyrtoi dokumentacionin përkatës dhe intervistoi zyrtarë të ndryshëm, përfshirë përfaqësues të Drejtorive Komunale të Arsimit dhe zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Një nga çështjet kryesore të identifikuara ishte mungesa e transparencës në procesin e subvencionimit dhe dyshimet për favorizim të shtëpive botuese të caktuara. Po ashtu, u evidentuan mangësi në procedurat e prokurimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore, duke ngritur shqetësime për keqpërdorim të mundshëm të fondeve publike.

Komisioni gjithashtu vuri në dukje nevojën për rishikimin e politikave të subvencionimit të teksteve shkollore, për të siguruar barazi dhe transparencë në shpërndarjen e fondeve dhe materialeve mësimore për të gjithë nxënësit.

Më 18 tetor 2024, komisioni intervistoi zyrtarë të lartë të MASHTI-t, përfshirë sekretaren e përgjithshme Fadile Dyla, për të diskutuar gjetjet e hetimit.

Deri më tani komisioni nuk ka përgatitur një raport përfundimtar që do të përmbante gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e procesit të subvencionimit të teksteve shkollore.

5. Refuzimi i shumicës parlamentare për themelimin e katër komisioneve hetimore

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së

Me 3 tetor 2013, përmes thirrjes së seancës së jashtëzakonshme dhe duke mbledhur 40 nënshkrime të deputetëve, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! kërkuan formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës.[15]

Sipas propozuesve, duhet të hetohet baza ligjore e marrjes së vendimit për të nisur procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së dhe të bëhet hetimi i procedurave të ndjekura për procesin e tërësishëm të privatizimit, që nga shpallja e interesit deri te publikimi i kompanisë kinse më të mirë ofertuese, si dhe kërkesa për përmbylljen me miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pavarësisht rëndësisë së kësaj kërkesë, Komisioni Hetimor Parlamentar nuk u themelua, si pasojë e braktisjes së seancës nga ana e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Ky bojkot ishte një hap që u realizua pa dhënë asnjë arsytim të qartë për mospraninë e deputetëve të kësaj partie. Ky veprim është i papranueshëm në një sistem demokratik, ku çdo akt i tillë vetëm sa dëmton besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore dhe në proceset demokratike.

Në këtë kontekst, deputetët e PDK-së, me veprimin e tyre të hapur, shkelën Ligjin për Hetim Parlamentar. Sipas këtij ligji, në rastet kur 1/3 e deputetëve kërkojnë formimin e një komisioni hetimor, Kuvendi është i detyruar ta ngrisë atë, dhe ky nuk është një proces që varet nga vullneti i grupeve parlamentare, por është një detyrim ligjor dhe kushtetues. Refuzimi i PDK-së për të mbështetur këtë kërkesë nuk është thjesht një mosveprim politik, por një shkelje e detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore.

[15] *Transkript i Seancës Plenare*; Kuvendi i Kosovës; 13 tetor 2013; (Shih linkun:

http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2013_10_03_10_5185_al.pdf), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

Komisioni Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit

Më 8 shkurt 2024, Kuvendi i Kosovës dështoi të themelojë Komisionin Hetimor Parlamentar për të hetuar përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit. Ky dështim erdhi si pasojë e mungesës së kuorumit në seancën plenare, ku deputetët e pozitës nuk morën pjesë në votim, duke pamundësuar arritjen e numrit të nevojshëm të votave.

Propozimi për themelimin e këtij komisioni u iniciua nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila shprehu shqetësimin për dy zjarre të ndodhura në IML brenda një viti dhe për zhdukjen e mostrave të lidhura me rastin Dehari. Deputetja Blerta Deliu-Kodra theksoi nevojën për hetim të pavarur parlamentar për të zbardhur këto ngjarje dhe për të identifikuar përgjegjësit institucionalë.

Mungesa e pjesëmarrjes së deputetëve të pozitës në votim u kritikua nga opozita, e cila e interpretoi këtë veprim si përpjekje për të penguar hetimin dhe për të mbrojtur zyrtarët e përfshirë. Nga ana tjetër, përfaqësues të pozitës argumentuan se hetimet për këto raste janë në proces nga organet kompetente dhe se themelimi i një komisioni hetimor parlamentar do të ishte i panevojshëm dhe mund të ndërhynte në proceset hetimore ekzistuese.

Përplasjet ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës gjatë seancës reflektuan polarizimin politik rreth çështjes, duke ngritur pyetje mbi transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore në trajtimin e rasteve të ndjeshme si ai i Astrit Deharit.

Më 7 tetor 2024, Kryesia e Kuvendit konstatoi kalimin e afatit ligjor për themelimin e këtij komisioni, duke e hequr nga procedura e mëtejme kërkesën për themelim. Sipas nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, komisionet hetimore nuk mund të themelohen gjatë gjashtë muajve të fundit të mandatit të Kuvendit.[16]

Ky zhvillim nënkupton se, për shkak të afateve ligjore dhe mungesës së konsensusit politik, Kuvendi nuk arriti të themelojë komisionin e propozuar, duke lënë pa adresuar në nivel parlamentar çështjet e ngritura lidhur me përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në këto raste.

Komisioni Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në ministri dhe ndërmarrje publike qendrore

Më 28 mars 2024, Kuvendi i Kosovës mbajti një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në ministri dhe ndërmarrje publike qendrore. Kjo iniciativë u propozua nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i cili shprehu shqetësimin për rritjen e numrit të kontratave të negociuara pa shpallje publike, të njohura si kontrata njëburimore, gjatë qeverisjes aktuale.

[16] *Procesverbal i Kryesisë së Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 7 tetor 2024; (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_094_dt_07_10_2024_MK_dHdJgKqA.ta.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 tetor 2024).

Gjatë seancës, deputetët e opozitës argumentuan se këto procedura të prokurimit, të cilat kapin vlerën e qindra milionë eurove, janë përdorur në mënyrë të paarsyeshme dhe pa transparencë, duke ngritur dyshime për keqpërdorim të fondeve publike dhe favorizim të operatorëve të caktuar. Ata theksuan nevojën për një hetim parlamentar për të siguruar llogaridhënie dhe për të mbrojtur interesin publik.

Nga ana tjetër, deputetët e pozitës kundërshtuan themelimin e komisionit, duke argumentuar se procedurat e prokurimit janë në përputhje me ligjin dhe se ekzistojnë mekanizma të tjerë mbikëqyrës, si Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, që trajtojnë këto çështje. Ata shprehën shqetësimin se një komision hetimor parlamentar mund të politizojë procesin dhe të ndikojë negativisht në funksionimin e institucioneve.

Për shkak të mungesës së konsensusit dhe debatit të zgjatur, seanca e jashtëzakonshme u ndërpre pa arritur në votim për themelimin e komisionit. Më 7 tetor 2024, Kryesia e Kuvendit konstatoi se ka kaluar afati ligjor për themelimin e komisionit hetimor parlamentar, duke hequr nga procedura e mëtejme kërkesën për themelim.[17]

Komisioni Hetimor Parlamentar për procesin e përlllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Më 23 prill 2024, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dorëzoi një kërkesë për themelimin e një Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e përlllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit dhe mënyrën e shlyerjes së këtyre borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo kërkesë u bë pas dyshimeve për falje të kundërligjshme të borxheve që kapnin vlerën e rreth 11 milionë eurove, çështje e cila ishte nën hetim penal dhe kishte rezultuar me arrestime.

Pasi nuk u arrit mbështetja e nevojshme për themelimin e Komisionit Hetimor, më 27 shtator 2024, PDK kërkoi mbajtjen e një debati parlamentar për të njëjtën çështje. Megjithatë, edhe kjo iniciativë nuk gjeti përkrahje të mjaftueshme. Në mungesë të veprimeve konkrete, më 16 tetor 2024, Kuvendi mbajti një seancë të jashtëzakonshme për të debatuar mbi procesin e përlllogaritjes dhe shlyerjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, e drejta për të iniciuar themelimin e një komisioni hetimor i takon gjashtë deputetëve, një komisioni të përhershëm parlamentar ose një të tretës së anëtarëve të Kuvendit. Në rastet kur kërkesa parashtrohet nga një e treta e deputetëve, Kuvendi është i detyruar ta themelojë komisionin për çështjen e kërkuar. Në këtë rast, kërkesa e PDK-së nuk arriti mbështetjen e mjaftueshme për të përmbushur këtë kusht.

[17] *Procesverbal i Kryesisë së Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 7 tetor 2024; (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_094_dt_07_10_2024_MK_dHdJgKqA.ta.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 tetor 2024).

Ligji për Hetim Parlamentar përcakton se komisionet hetimore nuk mund të themelohen gjatë gjashtë muajve të fundit të mandatit të Kuvendit. Duke pasur parasysh se zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë planifikuar për në janar të vitit 2025, afati ligjor për themelimin e komisionit hetimor për këtë çështje konsiderohet i kaluar.[18]

6. Kaosi në komisionin hetimor për rastin e gylenistëve

Komisioni Hetimor Parlamentar për dëbimin e gjashtë shtetasve turq, një rast i njohur si rasti i gylenistëve, u shoqërua me tensione të shumta dhe një kaos të thellë në punimet e tij, duke nxjerrë në pah ndasitë politike dhe sfidat institucionale në Kosovë. Një nga momentet më të spikatura të këtij kaosi ishte mbledhja ku mori pjesë Presidenti i atëhershëm, Hashim Thaçi. Përkundër natyrës serioze të rastit, debati shpesh devijoi në përplasje të ashpra personale mes deputetëve dhe Presidentit, duke dëmtuar rëndësinë e çështjes në diskutim.

Hashim Thaçi, në paraqitjen e tij para Komisionit, mbrojti veprimet e institucioneve, duke insistuar se operacioni ishte në përputhje me interesat shtetërore. Për më tepër, ai nisi të bënte deklaratat dhe kërkesa ndaj Kryesuesit të Komisionit Hetimor mbi aryeshmërinë dhe mundësinë e konfliktit të interesit të njërit ndër ekspertëve që ky komision kishte caktuar. Kjo deklaratë dhe kërkesa e tij shkaktoi reagime të ashpra, veçanërisht nga deputeti Sami Kurteshi, i cili e akuzoi Presidentin për përgjegjësi të drejtpërdrejtë në shkeljet ligjore të evidentuara. Në anën tjetër, Presidenti Thaçi konsideroi se caktimi i ekspertit për shkrimin e raportit përbën konflikt të interesit ngase ai ishte më parë i punësuar i Avokatit të Popullit, që në këtë rast ishte deputeti Sami Kurteshi. Për këtë çështje, përplasje mes Thaçit dhe Kurteshit eskaloj, duke kaluar në tone personale dhe duke nxjerrë në pah antagonizmat e thella politike që kishin karakterizuar funksionimin e Komisionit.

Një tjetër moment tensioni shpërtheu mes deputetëve Anton Quni dhe Hajdar Beqa. Quni, i cili vinte nga opozita, kritikoi ashpër punën e institucioneve dhe e quajti operacionin një dështim të sigurisë kombëtare. Hajdar Beqa, nga ana tjetër, mbrojti qëndrimin e partisë në pushtet, duke i konsideruar akuzat si të pabaza dhe të motivuara politikisht. Kjo përplasje u shoqërua me ndërprerje të vazhdueshme të diskutimeve dhe një kaos të përgjithshëm gjatë mbledhjes.

Më tutje, dobësia e kryesimit të Komisionit nga Xhelal Sveçla u bë e dukshme gjatë këtyre tensioneve. Ai dështoi të ruante rendin në mbledhje, duke lejuar që përplasjet personale të dominonin diskutimet. Paaftësia e tij për të drejtuar mbledhjen në mënyrë efektive u kritikua gjerësisht, si nga anëtarët e Komisionit ashtu edhe nga opinionimi publik, duke theksuar mungesën e përvojës dhe autoritetit për të trajtuar një çështje kaq komplekse.

Përkundër mandatit të qartë për të hetuar shkeljet ligjore dhe për të siguruar llogaridhënie, puna e këtij Komisioni u kthye në një arenë akuzash dhe kundërakuzash mes partive politike, duke e devijuar fokusin nga vetë hetimi.

[18] *Procesverbal i Kryesisë së Kuvendit*, Kuvendi i Kosovës; 7 tetor 2024. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_094_dt_07_10_2024_MK_dHdJgKqA.ta.pdf), (Qasur për herë të fundit me 20 tetor 2024).

Ky rast illustroi se si çështjet e ndjeshme, që kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe neutralitet politik, mund të kthehen në burim kaosi kur mungon profesionalizmi dhe udhëheqja efektive. Në fund, një qasje e tillë, do të mund të dështonte përmbushjen e mandatit të komisionin duke e lënë rastin e gylenistëve pa një pasqyrë të plotë të përgjegjësive dhe shkeljeve ligjore, duke ngritur pikëpyetje të mëdha për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

7. Qeveria dhe Kuvendi janë vonuar në adresimin e gjetjeve nga hetimi për gylenistët tek Ligji për të Huajt

Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar mbi dëbimin e gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018 identifikoi 31 shkelje ligjore dhe kushtetuese gjatë këtij procesi.[19] Ndër shkeljet e evidentuara, disa lidhen drejtpërdrejt me Ligjin për të Huajt, përfshirë:

1. Shkelje të nenit 97, paragrafi 1: Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) lëshoi urdhra për largim me forcë pa plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë nen.
2. Shkelje të nenit 97, paragrafi 8: Urdhrat për largim me forcë nuk përmbanin informacionet e kërkuara, siç janë detajet mbi vendin dhe mënyrën e ekzekutimit të urdhrit, në kundërshtim me kërkesat e këtij neni.
3. Shkelje të nenit 6 dhe nenit 99, paragrafi 2: Urdhrat për largim me forcë u bazuan në këto nene, edhe pse ato nuk parashikojnë një bazë të tillë për nxjerrjen e këtij lloji urdhri.
4. Shkelje të nenit 8, paragrafët 1 dhe 3: Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) nuk siguroi fletudhëtime për shtetasit turq që nuk posedonin dokumente udhëtimi, duke mos përmbushur obligimet e përcaktuara në këtë nen.
5. Shkelje të nenit 30 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2014: Divizioni për Ripranim dhe Kthim (DRK) nuk verifikoi identitetin e shtetasve turq pa dokumente identifikimi, në kundërshtim me këtë nen.

Përkundër gjetjeve të tilla dhe një raporti të miratuar nga Kuvendi, ky i fundit dhe Qeveria nuk kanë arritur për më shumë se pesë vite të adresojnë dhe të sjellin një ligj të miratuar nga Kuvendi, sipas gjetjeve të këtij raporti. Projektligji për të Huajt ka qenë i planifikuar për miratim në secilin vit kalendarik, por i njëjti tek në vitin 2024 është proceduar për në Kuvend nga ana e Qeverisë së Kosovës.

8. Ndërhyrja në sistemin e drejtësisë përmes tentativës për themelimin e Komisionit hetimor parlamentar lidhur me mashtrimet me listat e veteranëve të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Në qershor të vitit 2019, kryetari i atëhershëm i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, propozoi themelimin e një Komisioni Hetimor Parlamentar për të hetuar mashtrimet e dyshuara në listat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kjo nismë erdhi pas akuzave publike dhe hetimeve të Prokurorisë Speciale lidhur me fryrjen e listave të veteranëve, ku dyshohej se mijëra persona kishin përfituar statusin e veteranit pa qenë pjesëmarrës në luftë.

Në kohën kur ky komision u propozua ngjalli kritika për ndërhyrje të mundshme në drejtësi dhe për krijimin e një paralelizmi me procesin penal që tashmë po zhvillohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Në këtë kontekst, një komision i tillë nuk kontribuon në zbardhjen e rastit, por mund të shfrytëzohet për qëllime të politikës ditore nga aktorët politikë, duke e bërë procesin më kompleks.

Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë në shtatorin e vitit 2018 kundër 12 personave për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar[20], duke argumentuar se nga pagesat e paligjshme për veteranët e UÇK-së, buxheti i Kosovës është dëmtuar në vlerën prej 68 milionë eurosh.

Sipas ligjeve në fuqi, hetimi dhe gjykimi i rasteve të tilla i takojnë Prokurorisë së Shtetit dhe sistemit gjyqësor. Ky rast ka qenë objekt i presioneve të ndryshme, dhe është theksuar rëndësia që drejtësia të veprojë me pavarësi dhe profesionalizëm. Ndërhyrja nga politika apo krijimi i nismave paralele shihet si pengesë për funksionimin normal të institucioneve të drejtësisë.[21]

9. Kundërkushtetutshmëria dhe ndërhyrja në sistemin e drejtësisë përmes Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje

Në qershor të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për trajtimin institucional të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në familje, sipas propozimit të GP të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Ky hap u mirëprit si një përpjekje për të adresuar këto fenomene shqetësuese, por gjithashtu ngjalli shqetësime të thella në lidhje me respektimin e parimeve të ndarjes së pushteteve dhe ndërhyrjen në sistemin e drejtësisë.

Themelimi i këtij komisioni ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare. Sistemi i drejtësisë duhet të mbetet i pavarur dhe i paprekur nga ndikimet e pushtetit legjislativ. Nëse gjyqtarët dhe prokurorët detyrohen të raportojnë për punën e tyre para një komisioni parlamentar, kjo përbën një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në funksionimin e drejtësisë, duke rrezikuar parimin e ndarjes së pushteteve.[22]

IKD gjithashtu vëren se gjatë seancës ku u themelua komisioni, asnjë grup parlamentar nuk kundërshtoi publikisht këtë iniciativë mbi bazën se ajo mund të përbënte ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë. Kjo mungesë e debatit kritik në Kuvend ngre shqetësime mbi nivelin e kuptimit dhe respektimit të ndarjes së pushteteve nga ana e deputetëve.

[20] *Kush janë të akuzuarit në rastin e "veteranëve të rrejshëm"*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/kush-jane-te-akuzuarit-ne-rastin-e-veteraneve-te-rrejshem>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[21] *Kërkesa e Veselit për komision hetimor për veteranët po shihet si goditje ndaj Haradinajt*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/kerkesa-e-veselit-per-komision-hetimor-per-veteranet-po-shihet-si-goditje-ndaj-haradinajt>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[22] Naim Jakaj; Kuvendi i Dështimeve, Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/WEB-Kuvendi-i-deshtimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

Dhuna në familje, dhuna në bazë gjinore dhe dhuna seksuale janë probleme që kërkojnë një trajtim urgjent nga institucionet e Kosovës. Sidoqoftë, IKD argumenton se një qasje përmes komisioneve hetimore parlamentare nuk është mënyra e duhur për të adresuar këto çështje. Në vend të kësaj, është thelbësore që sistemi i drejtësisë të forcohet dhe të zbatohet me rigorozitet, përfshirë funksionalizimin e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike, i cili ende nuk është zbatuar.

Një qasje alternative dhe më e përshtatshme për mbikëqyrjen dhe adresimin e këtyre çështjeve mund të ishte përmes mekanizmave të tjerë parlamentarë, si interpelancat, pyetjet parlamentare ose kërkesat për raportim të ministrave përkatës. Këto mekanizma mund të sigurojnë llogaridhënie pa ndërhyrë drejtpërdrejt në punën e sistemit të drejtësisë.

Për më tepër, përdorimi i një komisioni hetimor për çështje të tilla mund të krijojë një precedent të rrezikshëm për ndërhyrje të ngjashme në të ardhmen. Ky precedent do të minonte më tej pavarësinë e institucioneve të drejtësisë dhe do të dobësonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Një tjetër aspekt problematik është mungesa e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve në procesin e krijimit dhe funksionimit të komisionit. Përfshirja e tyre është thelbësore për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe për të adresuar në mënyrë të plotë shkaqet rrënjësore të dhunës seksuale dhe dhunës në familje.

Në përfundim, ndërsa nevoja për të trajtuar dhunën seksuale dhe dhunën në familje është urgjente, përdorimi i mekanizmave të papërshtatshëm, si komisionet hetimore parlamentare, mund të rezultojë jo vetëm në një humbje kohe dhe burimesh, por edhe në përkeqësimin e situatës duke dobësuar institucionet kryesore që duhet të adresojnë këto çështje. Përqendrimi duhet të jetë në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe promovimin e bashkëpunimit efektiv ndërmjet institucioneve.[23]

10. Procedimi i kundërligjshëm i Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në një mënyrë që nuk është në përputhje me ligjin, mori vendimin që të përfshinte Draft-raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës në rendin e ditës për seancën plenare të datës 23 shkurt 2023. Për më tepër, gjatë mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit më 16 janar 2023, Kryetari i Kuvendit, gjatë fjalës së tij, theksoi nevojën që raporti i KHP-së të miratohej brenda mandatit të tij dhe më pas të procedohej për shqyrtim në seancë plenare. Megjithatë, përkundër pasigurisë që ai shprehu, ai mundësoi që raporti të vihej në votim.[24]

[23] Komisioni i Venecias; "Parameters on the relationship between the parliamentary majority and the opposition in a democracy: a checklist"; par. 24; Venecia; 24 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e)), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

[24] "Procesverbal i Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit"; Kuvendi i Republikës së Kosovës; 16 janar 2023; (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeDocumentFiles/Proc_nr_054_dt_16_01_2023_MK_zncótUArmj.pdf), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

Ligji Nr. 03/L-176 për hetim parlamentar parashikon që raporti përfundimtar të miratohet nga Komisioni me konsensus dhe, në rast se nuk arrihet konsensusi, të votohet me shumicë të thjeshtë të votave. Po ashtu, në nenin 23 (5) të këtij ligji specifikohet se "Kryetari i Komisionit ia dorëzon raportin përfundimtar Kuvendit brenda dhjetë (10) ditëve nga miratimi i tij nga Komisioni." Kjo procedurë nuk u ndjek as në mbledhjen e fundit të Komisionit, të mbajtur më 15 dhjetor 2022, për shkak të mungesës së kuorunit. Kryetari i Komisionit Hetimor, Driton Selmanaj, ka sqaruar se mungesa e kuorunit ka qenë rezultat i bojkotit nga deputetët e grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerësoi se procedimi i Draft-raportit të Komisionit Hetimor për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare ka qenë në shkelje të Ligjit për hetim parlamentar.[25] Po ashtu, deputetët e grupit parlamentar që nuk morën pjesë në mbledhjen e Komisionit kanë vepruar në kundërshtim me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre kushtetuese, siç janë përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës. Sipas ligjit, deputetët anëtarë të Komisionit Hetimor që nuk janë dakord me konkluzionet e raportit përfundimtar kanë të drejtë të paraqesin mendimin e tyre të veçantë me shkrim, të cilin duhet ta bashkëngjitin raportit. Asnjë anëtar i Komisionit nuk ka paraqitur një mendim të tillë. Më 3 maj 2023, megjithëse procedura ishte e pasaktë, Kuvendi nuk e miratoi raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, procesi i miratimit të raporteve nga Komisionet Hetimore duhet të ndiqet në mënyrë strikte, duke respektuar një rend procedural të qartë. Sipas këtij ligji, raporti përfundimtar i Komisionit Hetimor duhet të miratohet fillimisht nga vetë Komisioni, me konsensus ndërmjet anëtarëve të tij. Nëse konsensusi nuk arrihet, raporti mund të votohet me shumicë të thjeshtë të votave. Ky është hapi i parë, dhe raporti pas miratimit nga Komisioni, duhet të dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar një transparencë të plotë dhe për të mundësuar që të gjithë deputetët të kenë mundësinë të shqyrtojnë dhe të votojnë raportin në seancën plenare.

Sidoqoftë, përderisa ligji parashikon një procedurë të tillë, ka pasur raste kur ky proces nuk është zbatuar siç duhet. Në rastin e raportit të Komisionit Hetimor lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës, Kuvendi i Kosovës ka proceduar në mënyrë të kundërligjshme, duke përfshirë Draft-raportin në rendin e ditës të seancës plenare pa e kaluar më parë për miratim në Komision. Ky veprim ka krijuar pasiguri ligjore, pasi nuk është respektuar hapi i parë i procesit të votimit në Komision, i cili është i domosdoshëm për ta bërë raportin të vlefshëm për shqyrtim në Kuvend. Kryesia e Kuvendit ka shkelur dispozitat e ligjit duke e dërguar raportin në seancën plenare për miratim pa kaluar në fazën e parë të votimit nga Komisioni.

Në përfundim, ligji është i qartë në lidhje me sekuencimin e hapave për miratimin e raporteve të Komisioneve Hetimore, dhe çdo shmangie nga kjo procedurë krijon rrezik për cenuar integritetin e procesit parlamentar.[26]

[25] Naim Jakaj; *Kuvendi i Dështimeve*; Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/ËEB-Kuvendi-i-deshtimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[26] Neni 23; Ligji për Hetim Parlamentar; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, kjo ndikon në besueshmërinë e institucioneve, pasi çdo shkelje e ligjit nga ana e Kuvendit ose Kryesisë mund të nënkuptojë mungesë transparence dhe shkelje të të drejtave të deputetëve për të marrë pjesë në vendimmarrje sipas procedurave të parashikuara. Në këtë kuadër, është thelbësore që të respektohet secili hap procedural, për të siguruar legjitimitetin e veprimeve të Kuvendit dhe për të shmangur krijimin e dyshimeve për keqpërdorim të pushtetit parlamentar.

11. Shumica parlamentare pamundësoi kryerjen e mandatit të Komisionit Hetimor

Një sfidë e rëndësishme ka qenë mungesa e kuorumit në mbledhjet e komisioneve. Shpesh, anëtarët nuk kanë marrë pjesë në takime, qoftë për shkak të përplasjeve politike apo për shkak të mospajtimit me temat që diskutoheshin. Mungesa e kuorumit jo vetëm që ka penguar zhvillimin e mbledhjeve, por edhe ka zvarritur proceset hetimore dhe nxjerrjen e përfundimeve.

Në një rast, më 30 korrik 2024, konstituimi i Komisionit Hetimor për Tekstet Shkollore dështoi për shkak të mungesës së kuorumit. Në mbledhje ishin të pranishëm vetëm katër deputetë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi mungonin.[27]

Më 5 korrik 2022, mbledhja e Komisionit Hetimor për Menaxhimin e Krizës Energjetike u shty për shkak të mungesës së kuorumit. Në këtë mbledhje ishte paraparë diskutimi për emrat e ekspertëve, por mungesa e deputetëve pengoi zhvillimin e saj.

Me 24 qershor 2022, dështoi të mbahej mbledhja e Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike.[28]

Pamundësimi i mandatit të Komisionit Hetimor Parlamentar për Rezervat Shtetërore në Kosovë është një rast tjetër i veçantë që ka nxjerrë në pah sfida të mëdha në procesin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies institucionale. Shumica parlamentare, përmes bojkotit të vazhdueshëm[29] dhe mungesës së kuorumit, pengoi vazhdimin e punës së komisionit[30], duke e lënë atë të përfundojë mandatin pa përmbushur detyrat për të cilat ishte krijuar. Ky akt ka ngritur pikëpyetje mbi rolin dhe përgjegjësinë e shumicës në promovimin e transparencës dhe kontrollit mbi veprimtarinë qeveritare. Në një rast, mbledhja e Komisionit u thirrë nga Kryesuesi, por vet ai nuk ishte preznet në këtë mbledhje.[31]

[27] *S'ka kuorum, dështon konstituimi i Komisionit hetimor për tekstet shkollore*; Reporter; (Shih linkun: <https://reporteri.net/lajme/ska-kuorum-deshton-konstituimi-i-komisionit-hetimor-per-tekstet-shkollore/>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[28] *Dështon mbledhja e Komisionit hetimor për energjinë*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/deshton-mbledhja-e-komisionit-hetimor-per-energji>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[29] *Mbledhja e Komisionit për rezervat shtetërore dështon në mungesë të deputetëve të pushtetit*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/mbledhja-e-komisionit-per-rezervat-shteterore-deshton-ne-mungese-te-deputeteve-te-pushtetit>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[30] *Pas shtatë dështimesh, konstituohet Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/pas-shtate-deshtimesh-konstituohet-komisioni-hetimor-per-rezervat-shteterore>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[31] *Në ngërg procesi hetimor për rezervën shtetërore*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/ne-ngerc-procesi-hetimor-per-rezerven-shteterore/>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

Ky veprim përbën një shembull të qartë të mungesës së vullnetit politik për të garantuar transparencë dhe për të ndjekur çështjet që lidhen me dyshimet për keqpërdorime në menaxhimin e rezervave shtetërore.

Rasti është i rëndësishëm për të kuptuar ndikimin e politizimit të procesit hetimor. Shumica parlamentare, duke bojkotuar mbledhjet, jo vetëm që dëmtoi kredibilitetin e Kuvendit, por gjithashtu krijoi një precedent negativ për funksionimin e komisioneve të ardhshme. Një veprim i tillë përforcon perceptimin se interesi partiak shpesh prevalon mbi interesin publik dhe të drejtën për llogaridhënie. Përveç kësaj, rasti vë në pah nevojën për ndryshime ligjore dhe procedurale që do të parandalonin sabotimin e komisioneve nga shumica parlamentare. Një ndërhyrje e tillë do të garantonte që mbikëqyrja parlamentare të mos pengohet nga bojkotet politike dhe që të gjitha palët të mbajnë përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve të tyre institucionale.

Refuzimi i shumicës parlamentare për të mbështetur funksionimin e këtij komisioni përbën një shkelje të Ligjit për Hetim Parlamentar. Ky veprim pengon zbardhjen e çështjeve të ndjeshme dhe përbën një precedent të rrezikshëm për mbikëqyrjen parlamentare. Komisioni i Venecias, në një raport të tij, thekson se krijimi i një komisioni hetimor nuk do të sillte dobi për anëtarët e opozitës që e kërkuan atë, përveçse nëse ky komitet ka fuqi të mjaftueshme për të realizuar një hetim efektiv dhe rezultatet e tij paraqiten dhe diskutohen në Parlament.[32]

12. Abuzimi me të drejtën e shumicës

Ligji për Hetim Parlamentar, ka precizuar në mënyrë të qartë dhe të saktë se çfarë çështjesh mund të propozohen për t'u hetuar.[33] Në shumicën e rasteve, çështjet që janë propozuar kanë qenë çështje në pajtim me kërkesat e ligjit për hetim parlamentar. Por, në mënyrë të hapur një dispozitë e tillë është shkelur nga shumica parlamentare në Legjislaturën e VIII-të. Refuzimi për të themeluar komisionin hetimor për energjinë elektrike, për hetimin në lidhje me rezervat shtetërore, për hetimin e kontratave njëburimore, përbën situatë kur shumica parlamentare abuzon me të drejtën e saj dhe refuzimin e saj për të hetuar çështje që mund të shpien në gjetje për ministra prej nga partia politike që janë votuar.

Kur deputetët e shumicës parlamentare nuk marrin pjesë në votimin për një çështje me interes publik, kjo situatë mund të interpretohet në disa mënyra që ngrejnë pikëpyetje mbi angazhimin dhe përgjegjësinë e tyre ndaj mirëqenies së qytetarëve dhe demokracisë parlamentare. Në rastin e refuzimit të shumicës parlamentare për të mbështetur hetimin e procesit të kontratave njëburimore në Kosovë, kjo sjellje mund të reflektojë prioritete politike mbi interesat publike, e për tepër edhe abuzim me të drejtën dhe fuqinë që e ka shumica parlamentare.[34]

[32] Komisioni i Venecias, "Parameters on the relationship between the parliamentary majority and the opposition in a democracy: a checklist"; par. 134; Venecia; 24 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e)), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

[33] Neni 2, Ligji për Hetim Parlamentar; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

[34] Komisioni i Venecias, "Parameters on the relationship between the parliamentary majority and the opposition in a democracy: a checklist"; par. 20; Venecia; 24 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e)), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Së pari, mospjesëmarrja mund të interpretohet si një përpjekje për të shmangur transparencën dhe llogaridhënien. Hetimi i kontratave njëburimore ka rëndësi të madhe për të siguruar përdorimin e duhur të fondeve publike dhe eliminimin e keqpërdorimeve. Mungesa e angazhimit për të votuar mbi këtë çështje ngre dyshime se shumica parlamentare mund të jetë e interesuar të mbrojë aktorët e përfshirë në këto kontrata, duke shmangur ekspozimin e gabimeve ose praktikave të dyshimta.

Së dyti, mospjesëmarrja në votim mund të shërbejë si një instrument politik për të bllokuar çështje të ndjeshme që mund të dëmtojnë reputacionin e qeverisë ose të aleatëve të saj. Duke refuzuar të mbështesin një hetim parlamentar, shumica parlamentare mund të përpiqet të shmangë një debat të gjerë publik mbi çështje që mund të dëmtojnë pozitën e saj politike.

Së treti, një sjellje e tillë minon parimet e demokracisë parlamentare dhe përgjegjësinë e deputetëve ndaj elektoratit të tyre. Deputetët janë zgjedhur për të përfaqësuar interesat e publikut dhe për të garantuar mbikëqyrjen e qeverisjes. Kur ata refuzojnë të marrin pjesë në votime për çështje të rëndësishme, ata dështojnë të përmbushin këtë mandat dhe dëmtojnë besimin e qytetarëve në institucionet demokratike.

Së fundi, kjo situatë nënvizon nevojën për reforma në proceset parlamentare dhe forcimin e kornizës ligjore për hetimet parlamentare. Për shembull, mund të shqyrtohet miratimi i mekanizmave që detyrojnë shumicën parlamentare të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje me interes të lartë publik. Kjo do të ndihmonte në zvogëlimin e tensioneve politike dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

13. Mbarëvajtja e mbledhjeve

Gjatë periudhës 2018-2024, mbledhjet e komisioneve hetimore parlamentare në Kosovë kanë qenë shpesh të karakterizuara nga përplasje të ashpra mes anëtarëve, të cilat kanë ndikuar në mbarevajtjen e tyre. Përplasjet midis deputetëve të partive të ndryshme politike shpesh janë fokusuar në akuza dhe kundërakuza, duke devijuar nga diskutimi mbi çështjet kryesore të hetimeve. Këto përplasje kanë krijuar një klimë të tensionuar, që ka ndikuar negativisht në funksionimin efikas të komisioneve.

Një nga rastet konkrete është mbledhja e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore, e mbajtur më 5 mars 2024. Kjo mbledhje u karakterizua nga përplasje të ashpra ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) e lëshuan mbledhjen pas një debati të tensionuar me deputeten e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Doarsa Kica-Xhelili. Përplasja filloi kur deputetët e LVV-së kundërshtuan mbajtjen e mbledhjes më 5 mars, duke argumentuar se kjo datë përkon me shënimin e Epopesë së UÇK-së dhe se ishin të angazhuar në aktivitete përkujtimore. Në përgjigje, deputetja Kica-Xhelili kritikoi qëndrimin e LVV-së, duke vënë në dyshim përkushtimin e tyre ndaj shtetësisë së Kosovës. Këto përplasje çuan në ndërprerjen e mbledhjes dhe largimin e deputetëve të LVV-së nga salla.[35]

[35] *Përplasje në Komisionin Hetimor, VV-ja lëshon mbledhjen*; Klan Kosova; (Shih linkun: <https://klankosova.tv/perplasje-ne-komisionin-hetimor-vv-ja-leshon-mbledhjen/>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

Një tjetër rast i ngjashëm ndodhi më 4 korrik 2024, gjatë mbledhjes së Komisionit Hetimor Parlamentar për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Në këtë mbledhje, prezantimi i listës së dëshmitarëve nga ekspertët e angazhuar shkaktoi përplasje ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës. Opozita shprehu shqetësime se MPJD-ja nuk kishte dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara, duke argumentuar se kjo mungesë informacioni ndikonte në përzgjedhjen e dëshmitarëve. Në anën tjetër, deputetët e pozitës kërkuan që lista të mos votohej në atë mbledhje, duke propozuar që anëtarët e komisionit të kishin kohë të shtonin propozimet e tyre për dëshmitarë. Pas diskutimeve të tensionuara, deputetët e pozitës lëshuan mbledhjen, duke e lënë komisionin pa kuorum dhe duke penguar vazhdimin e punës.[36]

Komisioni Hetimor Parlamentar për Rezervat Shtetërore në Kosovë dështoi të konstituohet shtatë herë radhazi, për shkak të mungesës së kuoromit, kryesisht si pasojë e bojkotimit nga deputetët e pozitës. [37] Mungesa e deputetëve të shumicës parlamentare është e pajustificuar, jo etike dhe jodemokratike që deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) të mos marrin pjesë në konstituimin e komisionit, duke theksuar se kjo shkel Ligjin për Hetim Parlamentar, i cili parashikon që mbledhja e parë e komisionit të mbahet jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së vendimit të Kuvendit për themelimin e tij. Duke mos konstituuar komisionin, deputetët shkelin këtë ligj[38] dhe pengojnë hetimin e dyshimeve për keqpërdorime me rezervat shtetërore.

Gjuha joparlamentare është bërë zakonshmëri në shumë mbledhje të komisioneve hetimore. Përdorimi i termave ofendues dhe fyerjeve personale nga deputetët ka dëmtuar seriozisht seriozitetin dhe integritetin e këtyre komisioneve. Incidentet e tilla jo vetëm që kanë penguar dialogun konstruktiv, por kanë ndikuar edhe në perceptimin e publikut ndaj punës së komisioneve si jo profesionale dhe të orientuar nga konfliktet.

Ndërprerjet e vazhdueshme dhe shpërqendrimet nga temat e hetimeve kanë qenë një tjetër pengesë për mbarevajtjen e mbledhjeve.[39] Debatet shpesh kanë dalë jashtë kornizës së çështjeve të planifikuara, duke çuar në një shpërdorim të kohës dhe burimeve. Për më tepër, mungesa e disiplinës gjatë mbledhjeve ka penguar zbatimin e rregullave procedurale dhe arritjen e rezultateve konkrete.

Mungesa e një fryme bashkëpunuese mes deputetëve të komisioneve ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e punës së tyre. Në vend që të bashkëpunonin për të arritur rezultate objektive dhe të besueshme, shpesh anëtarët janë përfshirë në konflikte të brendshme politike, duke minuar rolin e tyre si trup hetimor. Si rezultat, shumë komisione hetimore nuk kanë arritur të përmbushin qëllimin për të cilin janë krijuar, duke dëmtuar efektivitetin e tyre dhe duke ulur besimin e publikut në to.

[36] *Përplasje në Komisionin Hetimor për MPJD-në rreth listës së dëshmitarëve, deputetët e pozitës lëshojnë mbledhjen*; Gazeta Express; (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/perplasje-ne-komisionin-hetimor-per-mpjd-ne-rreth-listes-se-deshmitareve-deputetet-e-pozites-leshojne-mbledhjen/>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[37] *Pas shtatë dështimesh, konstituohet Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore*; Koha; (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/pas-shtate-deshtimesh-konstituohet-komisioni-hetimor-per-rezervat-shteterore>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[38] Neni 11, Ligji për Hetim Parlamentar; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

[39] *Komisionet Hetimore, pengje të agjendave partiake*; Evropa e Lirë; (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/komisione-hetimore-parlamentare-/29934911.html>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

14. Refuzimi për të hetuar çështjen e propozuar

Paragrafi 3 i Nenit 4 të Ligjit për Hetim Parlamentar, ka saktësuar procedurën për ngritjen e një komisioni hetimor ku ai parashtrohet nga një e treta e deputetëve të Kuvendit. Sipas këtij paragrafi, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare themelon Komisionin për çështjen e kërkuar.

Në disa raste, edhe kur 1/3 e deputetëve të Kuvendit propozuan komisione hetimore, ato u zvarritën nga ana e shumicës parlamentare duke shkelur kështu ligjin për hetim parlamentar dhe duke e shmangur procesin e hetimit për çështjen e propozuar. Kjo ndodhi veçanërisht me votimin për caktimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.[40] Në lidhje me nevojën që shumica parlamentare të mos abuzojë, Komisioni i Venecias ka miratuar Listën e Kontrollit ku rol të veçantë i është dhënë detyrimit që shumica parlamentare të ofrojë qeverisje përgjegjëse dhe llogaridhënese.[41]

Pamundësia e Kuvendit për të marrë vendime paraqet një kërcënim serioz për funksionimin e demokracisë në vend. Kur ky kufizim i procesit legjislativ është rezultat i vullnetit të shumicës parlamentare për të dobësuar mbikëqyrjen parlamentare mbi institucionet shtetërore, pasojat bëhen më të rënda, pasi dëmtohet balance i pushteteve dhe rrezikohet transparenca e administratës publike.

Në këtë kontekst, pasivizimi i Kuvendit dhe kufizimi i mundësive të tij për të ushtruar funksionin e tij mbikëqyrës ndaj ekzekutivit dhe administratës shtetërore e forcon ndikimin e grupeve të interesit dhe e zvogëlon llogaridhënien e institucioneve përballë qytetarëve. Ky lloj cenimi i pavarësisë dhe autoritetit të Kuvendit rrezikon të shkaktojë një shtet të dobët dhe një demokraci të paqëndrueshme, ku politika zhvillohet larg vëmendjes dhe kontrollit të qytetarëve.

Themelimi i komisioneve hetimore sipas kërkesës së një të tretës së deputetëve siguron një mjet të fuqishëm për t'i balancuar pushtetet dhe për ta mbikëqyrë ekzekutivin. Duke e detyruar Kuvendin të veprojë kur kërkohet nga një numër i konsiderueshëm deputetësh, kjo dispozitë forcon mekanizmin e kontrollit dhe parandalon abuzimin me pushtet nga institucionet ekzekutive ose të tjera, duke i garantuar transparencën dhe përgjegjshmërinë. Duke pasur parasysh se Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë, një grup prej 40 deputetësh përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të diversitetit politik dhe interesave qytetare. Një dispozitë e tillë siguron që asnjë shumicë parlamentare të mos pengojë hetimin e çështjeve të rëndësishme për demokracinë, duke kontribuar në transparencë dhe llogaridhënie.

[40] Transkript i Seancës Plenare; Kuvendi i Kosovës; (Shih linkun:

https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_05_05_ts_Seanca_5Bnr89WmEY.pdf), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2024).

[41] Komisioni i Venecias; "Parameters on the relationship between the parliamentary majority and the opposition in a democracy: a checklist"; par. 20; Venecia, 24 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e)), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Në anën tjetër, kërkesa për një të tretën e deputetëve për iniciimin e komisioneve hetimore është në përputhje me dispozitat kushtetuese që parashikojnë fuqinë e një të tretës së deputetëve për të ndërmarrë veprime të rëndësishme, siç janë propozimi i amendamenteve kushtetuese apo iniciimi i shpërndarjes së Kuvendit. Kjo krijon një standard të njëtrajtshëm për vendimmarrjen parlamentare dhe forcon të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar adresimin e çështjeve kritike.

15. Ushtrimi i detyrës përtej përkatësisë partiake

Ushtrimi i detyrës përtej përkatësisë partiake është një kërkesë thelbësore për ruajtjen e paanshmërisë dhe integritetit të procesit hetimor në Kuvendin e Kosovës. Anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar (KHP) duhet të kuptojnë se hetimi i çështjeve të rëndësishme ka pasoja të mëdha për jetën publike dhe duhet të trajtohet me seriozitetin e kërkuar, pa ndikime të jashtme nga partitë politike. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ata të veprojnë si individë të pavarur, duke siguruar që veprimet e tyre të mos kenë të bëjnë me interesat partiake, por vetëm me kërkesën për të zbardhur të vërtetën.

Kjo kërkesë është gjithashtu e nevojshme për ta ruajtur besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore. Nëse anëtarët e KHP-së janë të detyruar të veprojnë sipas udhëzimeve të partive të tyre, mund të dëmtohet besimi në paanshmërinë e procesit hetimor dhe mund të krijohet përshtypja e një hetimi të manipuluar, i cili është i prirur të mbrojë interesat partiake sesa të zbulojë të vërtetën. Prandaj, është e rëndësishme që ligji dhe rregullat e KHP-së të sigurojnë mekanizma që mundësojnë veprimet e pavarura dhe të paanshme të anëtarëve të tij, pa ndikuar nga ndikime politike.

Përveç kësaj, qasja e tillë i jep mundësinë hetimeve të kenë efektivitet më të madh, duke garantuar që çështjet të shqyrtohen me një objektivitet të lartë dhe pa paragjykitime të brendshme. Hetimi nuk duhet të jetë i ngarkuar me presione të jashtme, duke përfshirë ato nga partitë politike, sepse kjo mund të çojë në manipulime ose fshehjen e informacionit të rëndësishëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që anëtarët e KHP-së të veprojnë si individë të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime të bazuara në fakte dhe prova, pa pasur ndikim nga axhenda politike.

Në këtë kuadër, është gjithashtu e rëndësishme që mekanizmat e kontrollit të brendshëm të funksionojnë siç duhet për të siguruar se anëtarët e KHP-së janë duke vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe standardet etike. Ky është një element kyç për ruajtjen e besueshmërisë në proceset hetimore dhe për të parandaluar ndikimet e jashtme që mund të minojnë objektivitetin dhe transparencën. Kjo gjithashtu do të ndihmojë për të ruajtur integritetin e Kuvendit dhe do të sigurojë se hetimet janë të orientuara vetëm nga interesi publik dhe jo nga interesat e ngushta politike.

Ndonëse është e pritshme që përballjet ndërmjet partive politike të jenë normale dhe të domosdoshme në një demokraci, shumica parlamentare dhe opozita kanë përgjegjësi që t'i tejkalojnë dallimet kur bëhet fjala për kërkesën për llogaridhënie dhe përgjegjësi ndaj shoqërisë. Një angazhim i tillë duhet t'i tejkalojë interesat partiake, ndërkohë që shumica parlamentare duhet të jetë në gjendje të veprojnë me vetpërbajtje dhe respect ndaj opozitës.[42]

[42] Komisioni i Venecias, "Parameters on the relationship between the parliamentary majority and the opposition in a democracy: a checklist", par. 25; Venecia; 24 qershor 2022; (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e)), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

16. Dështimi i Kuvendit për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore parlamentare

Sigurimi i llogaridhënies, promovimi i besimit publik dhe mbrojtja e vlerave demokratike varen thelbësisht nga transparencën në funksionimin e komiteteve hetimore parlamentare. Fatkeqësisht, të gjitha Komitetet Hetimore Parlamentare (KHP) të krijuara gjatë Legjislaturës VIII-të kanë dështuar në mënyrë të konsiderueshme në mbajtjen e këtyre parimeve. Problemet kryesore përfshijnë mungesën e transmetimeve live të mbledhjeve të komiteteve dhe dështimin për të publikuar dokumentet zyrtare, si aktet e mbledhjeve dhe transkriptet. Mungesa e transparencës vërehet edhe gjatë themelimit të komisioneve hetimore në legjislaturat e kaluara. Për më tepër, pak dokumente të komisioneve hetimore janë të vendosura në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

Ligji për Hetimin Parlamentar nuk përmban asnjë dispozitë që ndalon publikimin e dokumenteve të lidhura me mbledhjet që janë mbajtur në mënyrë publike. Në fakt, ky ligj përcakton qartë kushtet kur një komision mund të mbajë mbledhje të mbyllura, dhe në këto raste, nuk ka asnjë detyrim ligjor për të shpërndarë aktet ose regjistrimin e mbledhjeve.

Qasja aktuale e Kuvendit dëmton rolin e tij dhe besimin e publikut në funksionimin e tij. Transparenca duhet të jetë një shtyllë themelore e punës së komiteteve hetimore parlamentare, duke mundësuar që qytetarët të kuptojnë funksionimin e këtyre organeve. Kjo përfshin sigurimin që publiku të ketë qasje të shpejtë dhe të lehtë në informacionet kyçe, si mandati i komitetit, procedurat, dëshmitë dhe përfundimet përmes kanaleve të aksesueshme, si njoftimet në media, shpalljet publike të mbledhjeve dhe publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të Kuvendit.

Për më tepër, mungesa e transparencës në këto procese nuk pengon vetëm mbikëqyrjen publike, por gjithashtu kufizon mundësinë e shoqërisë civile, mediave dhe aktorëve të tjerë për të mbajtur qeverinë llogaridhënëse. Kur komisionet hetimore parlamentare nuk ofrojnë informacion të qasshëm dhe të shpejtë, ato zvogëlojnë efektivitetin e qeverisjes demokratike dhe kontribuojnë në një rritje të ndarjes mes përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve që ata përfaqësojnë.

17. Të metat e Ligjit Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar

Ligji për Hetim Parlamentar, një ndër shtyllat kryesore për operacionalizimin e mbikëqyrjes së Kuvendit ndaj institucioneve ekzekutive dhe publike, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 qershor 2010. Ky ligj përcakton procedurat dhe kompetencat e komisioneve hetimore parlamentare për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në qeverisje. Që nga miratimi i tij, ligji nuk ka pësuar asnjë ndryshim, pavarësisht kërkesave të shumta të organizatave të deputetëve, shoqërisë civile dhe ekspertëve për t'i adresuar mangësitë që kanë dalë në pah gjatë zbatimit të tij.

Mangësitë ligjore dhe funksionale të ligjit kanë ndikuar në kufizimin e efektivitetit të komisioneve hetimore. Ndër problemet kryesore janë paqartësitë në përcaktimin e kompetencave të komisioneve, kufizimin që grupit nismëtar të mos i takojë kryesimi, qartësimi i detyrimit për themelimin e KHP-ve nga 1/3 e deputetëve, mungesa e afateve kohore të qarta për hetimet, dhe kufizimet në aksesin e dokumenteve ose dëshmitarëve.

Më tutje, çështje që duhet të rregullohet është edhe caktimi i afatit për t'i propozuar anëtarët, buxhetimi i Komisionit në Kryesi dhe jo në seancë plenare, konflikti i interesit gjatë ushtrimit të detyrës, dërgimi formal i raportit për KHP te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe te Prokurori i Shtetit, mnitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe disa çështje të tjera teknike dhe administrative.

Këto të meta përkundër që janë evidentuar në shumë raste hetimore të rëndësishme, ku komisionet parlamentare janë përballur me sfida të mëdha për të përmbushur mandatin e tyre, ato nuk janë ndryshuar.

Nevoja për ndryshimin e këtij ligji është bërë gjithnjë e më urgjente. Përmirësimi i tij do të mundësonte një kornizë më të qartë dhe më funksionale për komisionet hetimore, duke i bërë ato më efektive në përmbushjen e rolit të tyre mbikëqyrës. Kjo kërkesë është reflektuar në raportet e organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandimet nga ekspertët ligjorë, të cilët kanë theksuar se përditësimi i ligjit është thelbësor për të forcuar mekanizmat demokratikë dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

a) Detyrimi për të themeluar KHP-të pa votim formal në seancë plenare kur iniciimi bëhet nga 1/3 e deputetëve

Ligji për Hetim Parlamentar përcakton qartë se kur propozohet formimi i një Komisioni Hetimor Parlamentar (KHP) nga 1/3 e deputetëve të Kuvendit, atëherë Kuvendi detyrimisht duhet ta formojë këtë komision. Fjala "detyrimisht" nuk lë hapësirë për interpretime subjektive apo zvarritje nga ana e shumicës parlamentare. Ky mekanizëm është vendosur për të siguruar një proces transparent dhe mbikëqyrës nga opozita dhe deputetët individualë, si një ndër funksionet thelbësore të Kuvendit për kontrollin e ekzekutivit dhe organeve të tjera publike.

Në disa raste, edhe kur janë mbledhur 40 nënshkrime të deputetëve si kusht i nevojshëm për iniciimin e KHP, shumica parlamentare ka përdorur taktika të zvarritjes për të prolonguar formimin e komisionit dhe nisjen e hetimit. Ky veprim jo vetëm që është në kundërshtim me frymën e ligjit, por edhe dëmton procesin e mbikëqyrjes demokratike. Zvarritja minon besimin e publikut në Kuvend si institucion mbrojtës të interesit qytetar dhe pengon shqyrtimin në kohë të çështjeve me interes të lartë publik.

Kur 1/3 e deputetëve kërkojnë formimin e një KHP, shumica parlamentare nuk ka të drejtë ligjore ose morale të refuzojë kërkesën. Roli i shumicës në këtë rast duhet të jetë thjesht formal, duke e përfshirë kërkesën në rendin e ditës dhe duke e miratuar atë në një seancë plenare. Votimi për këtë kërkesë është një akt formal, jo një proces vendimmarrës për të refuzuar kërkesën, pasi ligji ka paraparë që plotësimi i kushtit prej 1/3 të deputetëve e bën këtë kërkesë të detyrueshme.

Praktikat e refuzimit ose zvarritjes së formimit të KHP nga shumica parlamentare shpesh perceptohet si shmangie e përgjegjësisë dhe tentim për të penguar hetimin e çështjeve delikate. Ky deformim i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit krijon precedentë të rrezikshëm, ku pushteti ekzekutiv dhe institucionet e tjera mund të mos mbahen përgjegjëse për veprimet e tyre. Një Kuvend funksional duhet të jetë garantues i transparencës dhe i respektimit të ligjit, pavarësisht interesave të shumicës apo opozitës.

Mosrespektimi i detyrimit ligjor për formimin e KHP cenon parimet e demokracisë parlamentare dhe ndikon negativisht në funksionimin e Kuvendit si organ përfaqësues i qytetarëve. Për të parandaluar raste të tilla në të ardhmen, është e nevojshme që të përcaktohen afate të qarta ligjore për procesin e miratimit të kërkesës dhe të përforcohen mekanizmat sanksionues për shumicën parlamentare që nuk përmbush këtë obligim. Një qasje e tillë do të siguronte respektimin e parimeve të sundimit të ligjit dhe transparencës në funksionimin parlamentar.

Vlerësimet e Komisionit të Venecias, thonë se fuqia detyruese për të krijuar komisione hetimore duhet të arrijë një prag relativisht të lartë të deputetëve, ndërsa propozimi/kërkesa për themelimin e tyre mund të paraqitet nga një numër më i vogël por edhe nga deputetë individual. Ndryshimi i mundshëm ligjor nuk duhet t'i shtojë pengesë ngritjes së KHP-ve, por t'i zgjerojë këto mundësi.[43] Mundësi të mirë dhe të lehtë të themelimit të KHP-ve për nga formimi i detyrueshëm ka dhënë legjislacioni për hetimet parlamentar në Portugali, sipas së cilit formimi i detyrueshëm i një komisioni bëhet me iniciimin e mocionit për themelimin e tij nga 1/5 e të gjithë deputetëve.[44]

b) Një më shumë për "opozitën"

Përbërja e komisioneve hetimore parlamentare, sipas ligjit në fuqi, duhet të jetë në raporte sa më të afërta përfaqësimi, por gjithnjë një më shumë i takon shumicës parlamentare.

Në praktikë, kjo mënyrë e përfaqësimit ka rezultuar të jetë problematike ngase në shumicën e rasteve, shumica parlamentare ka abuzuar me këtë shumicë duke mos ardhur në mbledhje, duke mbivotuar opozitën, duke u larguar në mes të mbledhjes dhe rrjedhimisht duke mos vazhduar mbledhja e komisionit.

Në situata të tilla, kur deputetët e shumicës parlamentare veprojnë në këtë mënyrë, atëherë zgjidhja do të duhej të ishte që gjatë përcaktimit të përbërjes së Komisionit ai të përbëhet nga deputetët e partive të pozitës dhe opozitës, në raporte sa më të përafërta përfaqësimi dhe kjo diferencë e anëtarëve të përgjithshëm në raport opozitë/pozitë në Kuvend të mos jetë më shumë se një (1) anëtar i Komisionit.

Për më tepër, një përfaqësim më i balancuar në komisionet hetimore parlamentare do të parandalonte shumicën parlamentare nga kontrolli i njëanshëm i procesit hetimor dhe rezultateve të tij. Kur shumica ka kontroll absolut mbi komisionin, ekziston rreziku i manipulimit të hetimeve për të mbrojtur interesat e saj politike, duke minuar kështu besueshmërinë dhe transparencën e procesit. Një përfaqësim proporcional siguron që zëri i opozitës të dëgjohet dhe të merret parasysh në mënyrë të barabartë, duke garantuar se hetimet kryhen me integritet dhe paanshmëri. Kjo jo vetëm që forcon demokracinë parlamentare, por edhe rrit besimin e publikut në institucionet shtetërore.

[43] Venice Commission, "Final Opinion on the Draft Constitutional Law on Amendments and Changes to the Constitution of Georgia"; CDL-AD(2010)028: P. 25.

[44] *Legal Regime governing Parliamentary Inquiries*; The Portuguese Parliament 2019; (Shih linkun: https://www.parlamento.pt/sites/EN/Parliament/Documents/Legal_Regime_governing_Parliamentary_Inquiries_EN.pdf), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Gjithashtu, duke siguruar një përfaqësim proporcional të grupeve parlamentare në komisione, promovohet një kulturë e bashkëpunimit dhe dialogut ndërmjet pozitës dhe opozitës. Kjo mund të çojë në hetime më efektive, pasi diversiteti i opinioneve dhe ekspertizës kontribuon në shqyrtimin e plotë dhe të detajuar të çështjeve nën hetim. Një atmosferë bashkëpunuese mund të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve konsensuale dhe në miratimin e rekomandimeve që reflektojnë interesat e gjerë të shoqërisë, duke përmirësuar kështu vendimmarrjen në nivel shtetëror.

Edhe pse një parlament do të përbëhet dhe do të udhëhiqet nga mazhoranca, edhe pse parimi i përfaqësimit proporcional të pozitës dhe opozitës është i zbatueshëm, megjithatë nuk përjashtohet krijimi i një komisioni hetimor ku anëtarët e opozitës do të jenë më shumë për nga përbërja. “Në parlamentet e Gjeorgjisë dhe Estonisë, opozitës dhe shumicës i garantohet përfaqësim i barabartë në komisionet hetimore.”[45] Në këtë drejtim, pakicës parlamentare gjithëherë i rezervohet e drejta e ngritjes së një komisioni hetimor për një çështje të caktuar.

Së fundmi, vendosja e rregullave më të forta dhe më të qarta për pjesëmarrjen dhe angazhimin e anëtarëve të komisioneve është thelbësore për funksionimin efektiv të tyre. Kur anëtarët e shumicës parlamentare mungojnë qëllimisht ose largohen nga mbledhjet për të penguar punën e komisionit, procesi hetimor paralizohet. Duke përcaktuar sanksione për mungesat e pajustificuara dhe duke kërkuar kuorumin e nevojshëm për vazhdimin e mbledhjeve, sigurohet që komisionet të mund të kryejnë detyrat e tyre pa pengesa. Kjo garanton vazhdimësinë dhe efektivitetin e punës së komisioneve hetimore, duke u mundësuar atyre të arrijnë rezultate konkrete dhe të kontribuojnë në përgjegjshmërinë dhe transparencën e institucioneve publike.

c) E drejta e propozuesit për të drejtuar KHP-në

Në bazë të Ligjit për Hetim Parlamentar, Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga një grup parlamentar që nuk ka qenë iniciator i komisionit dhe që nuk bën pjesë në partitë e koalicionit qeverisës. Ndërkohë, Zëvendës Kryesuesi caktohet nga Kuvendi, bazuar në propozimin e iniciatorit ose grupit që ka inicuar krijimin e Komisionit.

Dispozita që përcakton se Kryesuesi i Komisionit Hetimor duhet të zgjidhet nga një grup parlamentar që nuk është iniciator i komisionit mund të interpretohet si kufizuese dhe jofunksionale. Argumenti kryesor është se grupi iniciator është ai që propozon krijimin e komisionit dhe si i tillë ka njohuri të thelluara për çështjen që trajtohet. Kjo përfshin njohjen e kontekstit, të dhënave paraprake dhe shqetësimeve që kërkojnë hetim, duke e bërë atë më të kualifikuar për të udhëhequr procesin hetimor. Përjashtimi i tij nga pozita e kryesuesit mund të kufizojë efektivitetin e komisionit dhe të krijojë një hendek në menaxhimin e drejtë të çështjes.

[45] *Procedural guidelines on the rights and responsibilities of the opposition in a democratic parliament 2008*; PACE Report by Mr. Karim van Overmeire; (Shih linkun: <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=11792&lang=en>), (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Për më tepër, roli i kryesuesit është vendimtar në drejtimin e punës së komisionit, në përgatitjen dhe udhëheqjen e seancave, dhe në formulimin e raportit përfundimtar. Një kryesues që nuk është iniciator i komisionit mund të ketë mungesë përkushtimi ose ekspertizë për çështjen specifike, duke ndikuar negativisht në procesin e hetimit. Për më tepër, kjo dispozitë mund të krijojë hapësirë për manipulime politike, ku partitë ose grupet që nuk janë të angazhuara seriozisht me çështjen mund të udhëheqin komisionin, duke e kthyer procesin në një farsë politike.

Argumenti që kryesuesi nuk duhet të jetë nga grupi iniciator mund të justifikohet me nevojën për neutralitet, por neutraliteti i kryesimit nuk garanton efektivitet. Përkundrazi, një kryesues që nuk e ka iniciuar çështjen mund të jetë më pak i informuar dhe më pak i motivuar për të arritur rezultate konkrete. Kjo përbën një pengesë në hetimin e drejtë dhe të thelluar të çështjes. Për të siguruar një balancë midis neutralitetit dhe ekspertizës, dispozita mund të rishikohet duke lejuar që grupi iniciator të propozojë kryesuesin, me mbikëqyrje nga Kuvendi për të shmangur keqpërdorimin e rolit.

E preferueshme sipas standardeve demokratike është që ky kryesim t'i lihet opozitës. Ky standard është vendosur edhe me Rezolutën Nr. 1601 e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në janar të vitit 2008, ku përveç të drejtës së opozitës për të kërkuar ngritjen e KHP-ve dhe pragut për të ngritur një komision të tillë, Asambleja ka vlerësuar se një anëtar i opozitës do të emërohet ose kryetar ose raportues i çdo komisioni hetimor.[46] Një aplikim pozitiv i tillë, i drejtimin të KHP-ve domosdoshmërisht nga opozita, shprehimisht e ka përcaktuar shteti i Kroacisë,[47] Malit të Zi,[48] Maqedonisë së Veriut,[49] Hungarisë,[50] etj.

Mbi këto argumente, Kuvendi duhet të nisë ndryshimet ligjore në atë mënyrë që ai që propozon duhet të kryesojë komisionin hetimor për çështjen e propozuar për ta hetuar.

d) Caktimi i afatit për t'i propozuar anëtarët

Paragrafi i tretë i Nenit 7 të Ligjit për Hetim Parlamentar (LHP) përcakton kompetencën e Kryesisë për t'i propozuar Kuvendit përbërjen e Komisionit Hetimor, bazuar në nominimet e dërguara nga grupet parlamentare. Megjithatë, rregullimi aktual nuk përmban një afat kohor për dorëzimin e nominimeve nga grupet parlamentare. Në rastet kur një grup parlamentar nuk i përgjigjet kërkesës së Kryesisë me kohë, Kryesia propozon përbërjen me ato nominime që janë bërë, ndërsa pozitat e pa nominuara mbeten të zbrazëta.

Për të shmangur këtë vakum procedural dhe për të siguruar efikasitet në procesin e formimit të komisioneve hetimore, është e domosdoshme që Ligji të përmbajë një afat të qartë kohor për dorëzimin e nominimeve.

[46] Nënparagrafi 2.2.8, Udhëzime procedurale mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e opozitës në një parlament demokratik; Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës 2008; (Shih linkun:

<https://pace.coe.int/pdf/0d53ca9154b39c6ea39e091169c79d435478b7d9cd19e4ac307a8a6e713d42db/resolution%201601.pdf>),

(Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

[47] Kushtetuta e Republikës së Kroacisë; neni 91.

[48] Rregullorja e Punës së Kuvendit të Malit të Zi; neni 79, par. 3. 2

[49] Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 118.

[50] Për më shumë shih: Inquiries by Parliaments: The political use of a democratic right 2000, veçanërisht tek: Granting rights to the opposition fq. 22.

Një afat i përcaktuar me ligj do të krijonte një kornizë të qartë dhe detyruese për grupet parlamentare, duke eliminuar vonesat dhe paqartësitë që mund të ndodhin gjatë procesit.

Propozimi për të vendosur një afat prej 7 ditësh nga dita kur Kryesia i drejton kërkesën grupeve parlamentare është i arsyeshëm dhe praktik. Ky afat kohor siguron një periudhë të mjaftueshme për diskutim brenda grupeve parlamentare dhe përgatitjen e nominimeve, duke mos penguar procesin e formimit të komisionit hetimor.

Vendosja e një afati shtatëditor do të ndikonte pozitivisht në funksionalitetin e Kuvendit, duke e bërë procesin e nominimit të qartë dhe të detyrueshëm. Grupet parlamentare do të ishin të detyruara të respektojnë këtë afat, çka do të shmangte mbetjen e pozicioneve të zbrazta dhe vonesat në formimin e komisioneve. Një mekanizëm i tillë do të rritte përgjegjësinë dhe disiplinën institucionale.

Në fund, një rregullim i tillë do të kontribuonte në rritjen e efektivitetit të komisioneve hetimore, duke garantuar që përbërja e tyre të jetë e plotë dhe e balancuar. Kjo do të forconte rolin e komisioneve si një instrument i rëndësishëm i mbikëqyrjes parlamentare dhe do të siguronte që çdo çështje e propozuar për hetim të trajtohej me seriozitet dhe kompetencë maksimale. Afati kohor është një mjet esencial për harmonizimin e procesit dhe për përmbushjen e objektivave ligjore dhe parlamentare.

e) Objekti i hetimit nuk mund të jetë çështje kontestimi

E drejta e pakicës parlamentare ose nga një e treta e deputetëve nuk duhet të dëmtohet duke ia cenuar objektin e hetimit, sepse kështu pakica ose 1/3 e deputetëve privohet nga përdorimi i një mekanizmi të garantuar, i cili i është besuar jo për interesat e saj, por për interesat e shtetit demokratik. Lidhur me këtë të drejtë, Kuvendi në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë të cenojë ngritjen e KHP-ve duke e përdorë vendimmarrjen e shumicës parlamentare, përveç rasteve kur shumica parlamentare pretendon për mos respektim të parimeve kushtetuese. Këtu hyjnë: parimi i ndarjes së pushteteve, i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajësisë, i paanshmërisë, i respektimit të jetës private të individit. Duke i tejkaluar këto parime, Kuvendi mund të dalë jashtë fushëveprimit të tij dhe të ndërhyjë në veprimtarinë e organeve të pavarura.

Kuvendi nuk mund të shkojë deri aty sa objekti i hetimit të propozuar të ndryshohet dhe të reduktohet sepse do të kontestohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare për ta ushtruar normal këtë të drejtë. Edhe në rastet kur duhet të ndryshohet ose të diktohet objekti i hetimit, ai nuk mund të bëhet pa lejen e pakicës.

Megjithatë, kur shumica parlamentare pretendon për cenimin e standardeve dhe parimeve kushtetuese në objektin e hetimit, ajo është e detyruar që të gjejë formulime të tjera, t'i dërgojë te pakica parlamentare e më pas kjo e fundit të riformulojë kërkesën e saj. Është detyrë e palëve që të orientohen në drejtim të marrëveshjes për ta ngritur KHP-në dhe jo të mohojnë atë.

Neni 24 i Ligjit për Hetim Parlamentar përcakton që Komisioni Hetimor menaxhon në mënyrë autonome një fond të veçantë, i cili miratohet nga Kuvendi bazuar në propozimin e vetë komisionit. Po ashtu, dispozitat ligjore që rregullojnë kompensimin dhe shpenzimet për ekspertët dhe dëshmitarët, siç zbatohen nga gjykatat, janë të aplikueshme edhe për Komisionin. Ky rregullim siguron një bazë ligjore për buxhetimin dhe mbulimin e shpenzimeve të punës së komisionit.

Megjithatë, ky rregullim del të jetë problematik pasi e detyron Komisionin Hetimor të kërkojë miratimin e seancës plenare për çështje të thjeshta administrative si miratimi i buxhetit. Kjo procedurë jo vetëm që shton burokracinë, por gjithashtu kufizon autonominë e komisionit dhe mund të pengojë efektivitetin e tij. Në vend të kësaj, këto çështje duhet të trajtohen në mënyrë të thjeshtuar, pa nevojën për aprovim nga seanca plenare.

Për më tepër, çështja e kompensimit për Kryetarin, Nënkryetarin dhe anëtarët e tjerë të Komisionit duhet të rregullohet përmes një rregulloreje të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit ose Kuvendi me shumicë të thjeshtë. Një rregullim i tillë do të standardizonte trajtimin e çështjeve administrative për të gjitha komisionet hetimore dhe do të evitonte vonesat dhe komplikimet në punën e komisionit.

Së pari, autonomia financiare e komisioneve hetimore është një komponent kyç për sigurimin e pavarësisë dhe funksionimit të tyre efektiv. Kërkesa për miratim të buxhetit nga seanca plenare krijon një varësi të panevojshme dhe potencialisht politizon procesin e vendimmarrjes. Çdo vonesë ose kundërshtim politik në seancën plenare mund të dëmtojë rrjedhën e punës së komisionit dhe të kompromentojë misionin e tij.

Së dyti, çështjet administrative si kompensimi dhe menaxhimi i fondeve nuk duhet të jenë subjekt i debatit në seancën plenare, pasi ato janë teknikalitete që mund dhe duhet të rregullohen përmes një kornize standarde administrative. Një rregullore e miratuar nga Kryesia e Kuvendit ose shumica e thjeshtë e deputetëve mund të sigurojë një zgjidhje uniforme dhe të aplikueshme për të gjitha komisionet hetimore, duke kursyer kohën dhe burimet e Kuvendit.

Së fundmi, një rregullim më i qartë dhe më praktik do të ndihmonte në forcimin e besueshmërisë dhe transparencës së komisioneve hetimore. Nëse fondet dhe kompensimet përcaktohen sipas një rregulloreje të veçantë dhe standarde, do të shmanget perceptimi i ndikimeve politike dhe do të sigurohet që komisionet të fokusohen vetëm në përmbushjen e mandateve të tyre hetimore. Kjo do të ndihmonte në rritjen e efikasitetit dhe pavarësisë së hetimeve parlamentare.

Në ligjin për hetim parlamentar, në nenin 9, paragrafi 2 thuhet se Komisioni vendos detyrimisht për largimin e një anëtari të Komisionit, nëse ai mungon tri (3) herë radhazi në punimet e Komisionit pa arsye të përligjshme.

Por, këto pa arsye të përligjshme nuk janë definuar në ligjin për hetim parlamentar.

Komisioni vendos detyrimisht për largimin e një anëtari të Komisionit nëse ai mungon tri (3) herë radhazi në punimet e Komisionit pa arsye të përligjshme. Me "arsye të përligjshme" do të duhej të nënkuptohej një situatë që përjashton përgjegjësinë personale të deputetit për mungesën, si: gjendje shëndetësore e dëshmuar me raport mjekësor, angazhime zyrtare të miratuara nga Kryetari i Komisionit, apo rrethana të paparashikuara që kanë pamundësuar pjesëmarrjen, të cilat duhet të dokumentohen dhe njoftohen paraprakisht ose menjëherë pas ndodhjes së tyre.

Deputetët anëtarë të Komisionit që pengojnë mbledhjet e Komisioneve Hetimore, duke mos marrë pjesë pa arsye të përligjshme ose duke ndërmarrë veprime që qëllimisht bllokojnë punën e Komisionit, i nënshtrohen masave ndëshkuese financiare. Këto masa duhet të jenë të njëjta dhe të përshtatshme me ato të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit për deputetët që pengojnë punimet në seancat plenare, si ndalesa e pjesëshshme e kompensimit financiar ose masa disiplinore të tjera të ngjashme.

Masat financiare dhe disiplinore të përcaktuara në këtë nen duhet të zbatohen në mënyrë transparente dhe të dokumentohen në procesverbalet e Komisionit. Për zbatimin e masave, Kryetari i Komisionit duhet të njoftojë Kryesinë e Kuvendit, e cila mbikëqyr zbatimin e ndëshkimeve sipas rregullave në fuqi.

Ky ndryshim ligjor është i domosdoshëm për të siguruar efikasitetin e punës së Komisioneve Hetimore si një nga mjetet kryesore për mbikëqyrjen parlamentare. Përfshirja e definimit të qartë të "arsyes së përligjshme" ndihmon në eliminimin e interpretimit subjektiv dhe keqpërdorimit të mundshëm nga anëtarët e Komisionit. Në të njëjtën kohë, ndëshkimet financiare për deputetët që qëllimisht pengojnë punën e Komisionit rrisin përgjegjshmërinë e tyre dhe parandalojnë sjelljet obstruksioniste, duke krijuar një standard të njëjtë me ndëshkimet që aplikohen në seancat plenare.

Shtimi i masave ndëshkuese financiare harmonizon përgjegjshmërinë e deputetëve në të gjitha nivelet e angazhimit të tyre parlamentar. Në mungesë të ndëshkimeve të përshtatshme, ekziston rreziku që Komisionet Hetimore të bëhen jofunksionale për shkak të mungesave të qëllimshme ose obstruksionit nga disa deputetë, duke minuar rëndësinë e mbikëqyrjes demokratike. Harmonizimi i këtyre masave ndëshkuese me ato të përcaktuara për seancat plenare siguron konsistencë ligjore dhe rrit besimin e publikut në seriozitetin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit.

h) Dërgimi i raportit për KHP-të te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe te Prokurori i Shtetit

Dorëzimi formal i gjetjeve të një raporti të komisionit hetimor parlamentar te Prokurori i Shtetit dhe te Zyra Kombëtare e Auditimit ka rëndësi të madhe ligjore dhe procedurale. Edhe pse Prokurori i Shtetit ka detyrimin ex officio të ndërmarrë hetime bazuar në informacionet e dhëna nga deputetët në seanca plenare dhe mbledhje të komisioneve hetimore, dorëzimi formal i raporteve siguron një kanal zyrtar komunikimi dhe dokumentimi.

Së pari, një raport i dorëzuar formalisht krijon një bazë të qartë dhe të dokumentuar për nisjen e hetimeve. Kjo shmang çdo paqartësi apo mungesë informacioni që mund të lindë nga diskutimet verbale në seanca apo mbledhje. Raporti përmban gjetje të detajuara, prova dhe rekomandime, të cilat mund të jenë thelbësore për procesin hetimor.

Së dyti, dorëzimi formal rrit përgjegjësinë dhe llogaridhënien e institucioneve. Kur një raport i tillë dërgohet zyrtarisht, krijohet një detyrim më i fortë për Prokurorinë dhe Zyrën e Auditimit që të veprojnë në përputhje me ligjin.

Së treti, në kuadër të procedurave ligjore, dorëzimi formal mund të jetë i domosdoshëm për të respektuar afatet dhe rregullat procedurale. Ligji për hetim parlamentar mund të parashikojë mënyrën dhe formatin e komunikimit ndërmjet institucioneve.

Së katërti, dorëzimi formal i raporteve mund të shërbejë si një mekanizëm mbikëqyrjeje dhe balancimi ndërmjet pushteteve. Parlamenti, duke dorëzuar raportet te organet hetimore dhe auditimi, siguron që gjetjet e tij të merren parasysh dhe të hetohen në mënyrë të pavarur.

Së pesti, kjo praktikë mund të nxisë efikasitetin në trajtimin e çështjeve të ngritura. Raportet e detajuara ofrojnë një pikënisje të mirë për hetimet, duke shmangur nevojën për grumbullim fillestar të informacionit nga zeroja.

Së gjashti, dorëzimi formal i raporteve mund të ketë edhe implikime juridike në rastet e procedimeve penale ose administrative. Dokumentimi zyrtar mund të përdoret si provë në gjykatë ose në procese të tjera ligjore.

i) Konflikti i interesit gjatë ushtrimit të detyrës

Aktualisht, Ligji për Hetimin Parlamentar në Kosovë nuk përfshin ndonjë dispozitë që adreson situatat e mundshme të konfliktit të interesit, gjë që mund të shkaktojë dyshime mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e hetimeve të kryera. Konflikti i interesit mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në besueshmërinë e procesit hetimor, duke pasur parasysh që individët që janë të angazhuar në hetime mund të kenë interesa të fshehura që ndikojnë në rezultatet. Për këtë arsye, është e nevojshme që LHP të përfshijë një dispozitë që kërkon deklarin e mundshëm të konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit dhe individët e tjerë që merren me çështjen e hetuar, si dhe një procedurë për konfirmimin e kësaj deklarate.

Për të siguruar transparencën dhe paanshinë e hetimeve, duhet të ekzistojë një mekanizëm që mundëson kontrollin dhe verifikimin e deklaratave të konfliktit të interesit. Kjo mund të arrihet përmes një sistemi të qartë procedurash, ku anëtarët e komisioneve hetimore duhet të paraqesin një deklaratë formale që dëshmon mungesën e çdo interesi personal që mund të ndikojë në objektivitetin e hetimeve. Po ashtu, çdo ekspert apo dëshmitar i ftuar duhet të kalojë në një proces të ngjashëm verifikimi për të garantuar që ata nuk kanë ndonjë lidhje që mund të ndikojë në besueshmërinë e informacionit që do të paraqesin gjatë hetimit.

Përveç kësaj, ligji duhet të specifikojë një procedurë për trajtimin e situatave kur një konflikt interesi mund të identifikohet pas fillimit të hetimit. Në raste të tilla, duhet të ketë masa të qarta për ndarjen e anëtarëve të prekur nga hetimi, ose për ndërrimin e të ftuarve që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen që po hetohet. Kjo do të ndihmojë në ruajtjen e integritetit të procesit hetimor dhe në forcimin e besimit të qytetarëve në ligjshmërinë dhe drejtësinë e veprimeve të Kuvendit të Kosovës.

j) Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve

Të shumëta janë rastet kur rekomandimet e komisioneve hetimore parlamentare nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së monitorimit të duhur. Mungesa e një mekanizmi efektiv të ndjekjes mund të çojë në neglizhimin e rekomandimeve dhe, si pasojë, në mungesën e ndryshimeve të nevojshme në institucionet ose politikat publike.

Në raste të tilla, është thelbësore që Kuvendi të ndërmarrë hapa për të adresuar boshllëqet në procesin e monitorimit. Kjo mund të përfshijë krijimin e strukturave ose procedurave të reja që sigurojnë ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të rekomandimeve dhe mbajtjen përgjegjëse të institucioneve përkatëse.

Ndryshimi i Ligjit për Hetim Parlamentar mund të jetë një opsion i domosdoshëm. Duke përfshirë dispozita që detyrojnë monitorimin e rregullt dhe raportimin mbi progresin e zbatimit, ligji mund të forcojë përgjegjësinë institucionale dhe të sigurojë që rekomandimet të mos injorohen.

Në anën tjetër, krijimi i një mekanizmi të brendshëm brenda Kuvendit mund të jetë një zgjidhje më e shpejtë dhe efektive. Një njësi e posaçme mund të ngarkohet me detyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe raportimit periodik para deputetëve.

Ky mekanizëm i brendshëm mund të funksionojë si një urë lidhëse midis komisioneve hetimore dhe institucioneve të cilave u drejtohen rekomandimet. Duke siguruar komunikim të vazhdueshëm dhe duke ndjekur progresin, mund të rritet efikasiteti i procesit dhe të sigurohet zbatimi praktik i rekomandimeve.

Është e rëndësishme që Kuvendi të marrë masa proaktive për të përforcuar rolin e tij mbikëqyrës dhe për të siguruar që rekomandimet e tij të kenë ndikim real në përmirësimin e qeverisjes dhe shërbimeve publike.

k) Çështje të tjera teknike dhe administrative

Gjatë punës së 15 komisioneve hetimore, janë vërejtur probleme teknike dhe administrative që ndikojnë në efikasitetin dhe etikën e tyre. Në çdo rast, Komisionet Hetimore Parlamentare kanë përdorur sallat e zakonshme të komisioneve të përhershme dhe funksionale. Në disa raste, këto salla kanë qenë aq të vogla sa kanë pamundësuar pjesëmarrjen e publikut, gazetarëve dhe vendosjen e kamerave, duke penguar edhe transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve.

Një çështje tjetër problematike është afërsia midis dëshmitarëve dhe personave përgjegjës që janë pjesë e hetimit me deputetët që do t'i marrin në pyetje. Në rastin e hetimit për çështjen e energjisë elektrike, personi kryesor i hetuar, një ambasador, shtrëngoi duart me anëtarët e komisionit dhe disa prej tyre i përqafoi, gjë që është në kundërshtim me të gjitha normat etike të sjelljes parlamentare, veçanërisht për deputetët.

Për të adresuar këto probleme, është e nevojshme që komisionet hetimore të kenë në dispozicion ambiente adekuate që mundësojnë pjesëmarrjen e plotë të publikut dhe mediave. Parlamenti duhet të sigurojë salla të mjaftueshme në madhësi dhe të pajisura me teknologjinë e nevojshme për transmetim të drejtpërdrejtë, duke garantuar transparencë dhe akses publik në proceset hetimore.

Gjithashtu, duhet të vendosen protokolle të qarta për sjelljen gjatë seancave hetimore. Këto protokolle duhet të përcaktojnë distancën dhe formalitetin që duhet të ruhet midis deputetëve dhe personave nën hetim, duke shmangur çdo formë të sjelljes që mund të komprometojë integritetin e procesit hetimor.

Trajnimi i deputetëve në etikën parlamentare dhe procedurat hetimore mund të ndihmojë në përmirësimin e profesionalizmit gjatë këtyre seancave. Një kod etik i detajuar duhet të përfshihet në rregulloren e parlamentit, duke përcaktuar qartë sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme gjatë interaksionit me dëshmitarët dhe të hetuarit.

